



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 231 Akti

Nr. 315 Vendimi
Tiranë, më 16.11.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datën 12 nëntor 2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Brahim Dragjoshi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shpresore, të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 15.11.2018 zhvilloi procedurën e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti, z. Brahim Dragjoshi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Pamela Qirko dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.1.2018, u caktua me mirëkuptim si kryesuese komisionere Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raportin (aktkontrollin)¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së z. Dragjoshi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë, ka ndërtim të paligjshëm;*
- *ka burime financiare për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë në deklaratat periodike vjetore;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka/ ka patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

12. Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në KLP ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 14.10.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në datën 15.10.2020 u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 16.10.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 6.11.2020.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 9.11.2020.

¹ Raporti/aktkontrolli nr. *** prot., datë 19.4.2018.

² Raporti me nr. *** prot., datë 31.10.2017.

³ Raporti nr. *** prot., datë 16.9.2019.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.11.2020, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

19. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Brahim Dragjoshi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

21.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për kryerjen e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe vendimmarrjen në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për kryerjen e vlerësimit të figurës dhe vendimmarrjen në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4. Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

⁴ 41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi që organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizës së aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe verifikimin e ligshmërisë së burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

23.2. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Pasuria e llojit “banesë”⁵, e legalizuar në fund të vitit 2015, e deklaruar më parë në proces legalizimi, filluar ndërtimi në vitin 1996 – përfunduar pjesërisht në vitin 2000 dhe se akoma vazhdon investimi – me sipërfaqe truall 514 m², sipërfaqe ndërtimi 63 m², e ndodhur në rrugën “***”, ***, Tiranë, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë nr. ***, datë 12.11.2015. Deklaron se zotëron 100% pjesë të kësaj pasurie.

24.1. Lidhur me vlerën e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është e pavlerësuar, por, duke iu referuar shpenzimeve që janë kryer ndër vite, vlera e saj është afërsisht rreth 7 milion lekë kosto ndërtimi.

24.2. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në Kukës; dhe (ii) të ardhurat nga pagat ndër vite.

24.3. Konkluzionet e ILDKPI-së lidhur me këtë pasuri

(i) Deklarim i pasaktë dhe i paplotë lidhur me pasurinë e mësipërme, pasi subjekti ka deklaruar banesë me sipërfaqe truall 514 m², sipërfaqe ndërtimi 63 m², sipas dokumentacionit të administruar, rezulton godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë, nga e cila, bodrum me sipërfaqe 63 m², kati përdhe me sipërfaqe 63 m², kati i parë me sipërfaqe 81 m², kati i dytë me sipërfaqe 76.5 m², sipërfaqja totale 283.5 m².

⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks ***në dosjen e ILDKPKI-së): (i) Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar datë 12.11.2015 dhe; (ii) kontratë shitblerjeje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2000.

(ii) Deklarim i pasaktë lidhur me vlerën e investimit në banesën e mësipërme, pasi në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës 2003” ka deklaruar shtëpi banimi, në ndërtim e sipër, vlera 3,000,000 lekë, në deklaratën e interesave private periodike 2004, ka deklaruar shtëpi banimi të ndërtuar vetë, vit ndërtimi 2000, vlera 4,000,000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë “Vetting” ka deklaruar vlerën rreth 7,000,000 lekë, si dhe mosdeklarim ndër vite të vlerave të investuara në këtë objekt.

(iii) Mungon dokumentacioni ligjor preventiv/situacion punimesh për objektin “godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë”, nga e cila, bodrum me sipërfaqe 63 m², kati përdhe sipërfaqe 63 m², kati i parë sipërfaqe 81 m², kati i dytë 76,5 m². Sipërfaqe totale = 283,5 m².

(iv) Ndërtim i paligjshëm i pasurisë “godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë”, nga e cila, bodrum me sipërfaqe 63 m², kati përdhe me sipërfaqe 63 m², kati i parë me sipërfaqe 81 m², kati i dytë me sipërfaqe 76.5 m², sipërfaqja totale = 283.5 m², bie ndesh jo vetëm me ligjin penal shqiptar (ndërtim i paligjshëm parashikohet si vepër penale në nenin 199/a të Kodit Penal), por edhe me funksionin e subjektit, si dhe kompromenton shumë rëndë figurën e tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

24.4 Deklarimi i kësaj pasurie në vite

24.4.1. Referuar deklaramit fillestar të pasurisë (dorëzuar në datë 15.3.2004 në ILDKPKI), konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “shtëpi banimi” **në ndërtim e sipër**, pas vitit 1996, e ndodhur në ***, Tiranë, me vlerë 3 milion lekë. Pjesa që zotëron 20%. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e familjes.

24.4.2. Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2004 (këtej e në vijim “DPV”) subjekti ka deklaruar shtëpi banimi me sipërfaqe 140 m², e ndodhur në ***, e ndërtuar vetë, e pahipotekuar. Viti i ndërtimit 2000. Vlera e deklaruar rreth 4,000,0000 lekë. Pjesa që zotëron 100%. Data/viti i krijimit të pasurisë: deklaruar viti 2000. Gjithashtu, ka deklaruar pasurinë e llojit “truall ndërtimi” (përfshirë dhe sipërfaqen e shtëpisë) prej 500 m² dhe se zotëron 100% të kësaj pasurie. Data/viti i krijimit të kësaj pasurie: deklaruar viti 1996.

24.4.3. Në rubrikën e veçantë të DPV/2004, subjekti ka deklaruar se kjo shtëpi banimi është ndërtuar me të ardhurat e familjes dhe nga shitja e banesës në Kukës. Gjithashtu, ka sqaruar se është e papërfunduar, e palegalizuar dhe se është futur në procedurat e legalizimit në zbatim të ligjit.

24.4.4. Ndërsa, në DPV/2015 ka deklaruar se është kryer legalizimi i banesës në datën 12.11.2015. Vlera e paguar për procedurat e legalizimit 288,000 lekë dhe 400,000 lekë me bono privatizimi.

24.5. Hetimi i kryer nga Komsioni lidhur me këtë pasuri

24.5.1. ALUIZNI, Drejtorja Kamëz, Vorë⁶, informon se subjekti i rivlerësimit me formularin nr. *** prot., datë 1.8.2006, ka vetëdeklaruar për legalizim objektin informal me adresë ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Kamëz.

24.5.2. Në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, subjekti i rivlerësimit është pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 28.7.2015 për objektin “godinë banimi, 3 kate + 1 kat nëntokë”, ndodhur në zonën kadastrale 2884, Komuna ***, Qarku Tiranë.

24.5.3. Objekti është legalizuar si objekt informal i ndërtuar në tokë në pronësi shtetërore. Subjekti ka kryer pagesat e parcelës ndërtimore prej 514.7 m² kaluar në pronësi të tij sipas VKM-së nr. 1657, datë 24.12.2018, në funksion të përfundimit të procedurës administrative të legalizimit të objektit informal, sipas vlerave dhe shumave të përcaktuara në mandatpagesat

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 28.2.2019.

dhe kontratën noteriale të kalimit të parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2015, redaktuar nga noterja publike D.P.

24.5.4. ZVRPP-ja Tiranë⁷, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë “truall” me sipërfaqe 514.7 m² + ndërtesë me sipërfaqe 63 m².

24.5.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ALUIZNI, Drejtoria Kamëz, Vorë dhe nga ZVRPP-ja Tiranë lidhur me këtë pasuri, rezulton se:

(i) në datën 12.3.2005, nëpërmjet formularit “vetëdeklarim për legalizim”, të dorëzuar në Komunën ***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar objektin “shtëpi banimi”, të ndërtuar në datën 15.6.2000, me sipërfaqe të zënë 450 m², sipërfaqe ndërtimi 110 m², nr. i kateve mbi tokë 2 dhe nëntokë ½ - gjysmë kati;

(ii) në datën 1.8.2006, nëpërmjet formularit “vetëdeklarim për legalizimin e objektit”- shtojca A, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar objektin “shtëpi banimi”, të ndërtuar në vitin 1999, me sipërfaqe të zënë 470 m², sipërfaqe ndërtimi 80 m², numri i kateve mbi tokë 3, nëntokë ½ - gjysmë kati;

(iii) në datën 22.7.2015, Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 3, ka bërë aktkualifikimin e objektit, sipas të cilit rezulton se objekti informal ka 514.7 m² parcelë ndërtimore, sipërfaqe të bazës së objektit 63 m², numër katesh 3 kate + bodrum;

(iv) në datën 24.7.2015, subjekti i rivlerësimit ka blerë⁸ nga ALUIZNI (shitës i autorizuar nga Këshilli i Ministrave) parcelën ndërtimore me sipërfaqe 514.7 m² dhe me sipërfaqe ndërtimi 63 m², të ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, Komuna ***, Qarku Tiranë. Referuar kontratës së kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, blerësi (subjekti i rivlerësimit) ka paguar vlerën 289,840 lekë, si edhe ka kryer pagesën me bono privatizimi në shumën 420,000 lekë;

(v) në datën 28.7.2015, është lëshuar leja e legalizimit në emër të subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, objektin “godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë”, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 514.7 m², sipërfaqe të ndërtimit 63 m², sipërfaqe totale të ndërtimit 283.5 m², numri i kateve mbi tokë 3 (tri) dhe numri i kateve nëntokë 1(një);

(vi) kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë në datën 12.11.2015 dhe po në këtë datë është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit. Referuar kartelës së pasurisë, godina 3 kate + 1 kat nëntokë ka këto të dhëna: (1) bodrumi me sipërfaqe 63 m²; (2) kati përdhe me sipërfaqe 63 m²; (3) kati i parë me sipërfaqe 81 m²; dhe (4) kati i dytë me sipërfaqe 76.5 m². Sipërfaqja totale e ndërtimit 283.5 m².

24.6. Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar të dhëna të plota dhe nuk e ka përshkruar saktësisht atë, konkretisht, duke mos pasqyruar sipërfaqen totale të ndërtimit, sipërfaqen e ndërtimit për çdo kat, ecurinë e punimeve për ndërtimin e këtij objekti, shpenzimet e kryera dhe burimin e krijimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer në vazhdimësi për ndërtimin e plotë të tij.

24.7. Gjithashtu, nga analizimi i të dhënave të mësipërme rezulton se: (1) ka mospërputhje në deklaramet e subjektit lidhur me periudhën e përfundimit të ndërtimit të këtij objekti, pasi, në DPV/2004 dhe në formularin e vetëdeklarimit për legalizim të datës 12.3.2005, është përcaktuar se objekti “shtëpi banimi” është ndërtuar në vitin 2000, ndërsa në formularin e vetëdeklarimit për legalizim të datës 1.8.2006, është përcaktuar viti 1999, si vit i ndërtimit të këtij objekti; (2) ka mospërputhje në deklaramet e subjektit lidhur me koston e ndërtimit të këtij

⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 18.2.2019.

⁸ Kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2015.

objekti, pasi, në deklarinimin fillestar është përcaktuar vlera 3,000,000 lekë, në DPV/2004, vlera 4,000,000 lekë dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” vlera 7,000,000 lekë; (3) ka mospërputhje lidhur me deklarinimet e kryera për sipërfaqen e truallit të zënë dhe sipërfaqen e ndërtimit.

24.7.1. I pyetur nga Komisioni lidhur me mospërputhjet në deklarinimet e bëra për vitin e ndërtimit dhe vlerën e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se⁹ *në vitin 1996 ka filluar të ndërtonte këtë objekt, ndërkohë që jetonte dhe punonte në Kukës. Fillimisht ka nisur investimin nga e para, duke hapur themelet dhe në vijim ndërtimin, duke punuar vetë me familje dhe të afërmit e tij gjatë kohës së lirë, çdo fundjavë e ditë pushimi, duke përfshirë edhe pushimet e sezonit të lejeve të zakonshme. Në vitin 2000, kjo banesë ka qenë në përfundim si objekt në dy katet e ndërtimit sipër themelit të ndërtesës.*

24.7.2. Në vijim të deklarimeve të tij lidhur me koston e ndërtimit të këtij objekti, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *përlllogaritja e investimit afërsisht për periudhën 1996 – 2000 është në vlerën 2,000,000 lekë, vlerë e siguruar nga kursimet, të ardhurat e familjes dhe më pas nga shitja e banesës në Kukës me vlerë 600,000 lekë, vlerë kjo, duke përfshirë shpenzimet “punëtori”, të cilat shumica janë kryer nga familja dhe të afërmit e tij. Gjithashtu sqaron se, ka shitur banesën në Kukës, duke formalizuar me aktin përkatës të shitjes në tetor të vitit 2000, ndërkohë që pjesën më të madhe të parave i kishte marrë më parë prej blerësit dhe i ka investuar deri në përfundimin e dy kateve, duke i bërë ato të përshtatshme për t’i vënë në shfrytëzim për të jetuar në qershor të vitit 2000, kohë në të cilën është shpërngulur nga Kukësi për në Tiranë me familje, ndërsa vetë ka vazhduar punë në Kukës deri në vitin 2002 dhe më pas është transferuar në Shkodër si Prokuror Apeli. Nga viti 2000 deri në vitin 2003 ka investuar në banesë çdo muaj të vitit nga paga dhe të ardhurat e tjera familjare thuajse ½ e pagës, po nuk ka mbajtur ose ruajtur fatura ngaqë investimi ka qenë i vazhdueshëm dhe në vlera të vogla. Diferenca midis deklarinimit në DPV/2003 me vlerë 3,000,000 lekë dhe DPV/2004 duke e shtuar vlerën e banesës me shumën prej 1,000,000 lekë brenda një viti, është një diferencë e hamendësuar nga ana e tij si përpjekje për t’i rritur vlerën banesës ose rivlerësuar edhe njëherë nga e para dhe jo një investim i realizuar brenda një viti kalendarik i bërë prej tij. Ndërsa, diferenca e padeklaruar në vitet 2005 – 2016 dhe deklarinimit “Vetting” ka ndodhur për arsye se vlerat e investuara nuk e kanë kaluar shumën e 300,000 lekëve si shpenzim që ishin objekt i këtij deklarinimi, shpenzimet kanë qenë të vogla dhe permanente. Referuar deklaratës “Vetting”, për efekt të pasqyrimit të një vlere sa më reale të kësaj banese ka hamendësuar se totali i investimit është afërsisht 7,000,000 lekë, duke llogaritur një investim mesatar prej 250,000 lekësh në vit për këtë periudhë (2005 – 2016), i cili është bërë në vlera të vogla të herëpashershme gjatë viteve. Këto investime në vlera të vogla janë bërë kryesisht për arredime të brendshme, fasadë të jashtme, sistemime oborri, etj.*

24.7.3. I pyetur sërish lidhur me mospërputhjen në vetëdeklarinimet e tij për vitin e ndërtimit, si edhe mospërputhjet e konstatuara në vetëdeklarinimet e bëra ndër vite për sipërfaqen e zënë dhe sipërfaqen e ndërtimit për këtë objekt, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se¹⁰ *për sa i përket vetëdeklarinimit për vitin e ndërtimit të shtëpisë së banimit, siç e ka theksuar edhe më parë, ndërtimi i shtëpisë ka filluar që në vitin 1996 dhe ka vazhduar me ritme shumë të ngadalta deri në vitin 1999 – 2000, periudhë e cila nuk mund të konstatohet plotësisht se në cilin vit ka përfunduar, por viti 2000 ka qenë periudha në të cilën e ka vënë në përdorim. Ndërsa në vetëdeklarinimet për sipërfaqen e truallit, ka sqaruar se sipërfaqja e truallit e përfutur nga ndarja me vëllezerit e tij, siç e ka shpjeguar edhe më parë, ka qenë 500 m², por në vetëdeklarinimin e vitit 2005, është vendosur sipërfaqja 450 m² për arsye se afërsisht 50 m² do lihej si rrugë e përbashkët dhe në atë kohë nuk ishte ndarë rruga nga trualli dhe për më tepër nuk ishte bërë matja nga specialistët e fushës. Në vetëdeklarinimet e vitit 2006, u përcaktua pjesa e rrugës që do lihej në 30 m² dhe matematikisht sipërfaqja e truallit reduktohej në 470 m². Në*

⁹ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹⁰ Përgjigje e pyetjes nr. 2, të pyetësorit nr. 3.

lidhje me sipërfaqen e ndërtimit deklaruar në vitin 2004 në masën 140 m², janë llogaritur për 2 katet e banimit, respektivisht nga 70 m² secili kat. Në vitin 2005 në deklarim është vendosur sipërfaqja 110 m², sipërfaqe kjo e kalkuluar për 2 katet e banimit, por në fakt është një e dhënë që mund të jetë vendosur në formularin e deklarimit ndryshe nga ajo reale, por pa asnjë qëllim të caktuar apo përfitim, kur në një kohë vlera e saktë duhet të ishte 70/80 m² për një kat (mendon se mund të jetë nga pakujdesia/neglizhenca apo lapsus). Në lidhje me deklarimin e vitit 2006, me sipërfaqe ndërtimi 80 m², ka sqaruar se kjo vlerë është llogaritur vetëm për një kat banimi, e matur dhe e konsultuar me specialistë të fushës.

24.7.4. Gjithashtu, nisur nga fakti se me formularin e vitit 2005 (datë 12.3.2005) subjekti ka vetëdeklaruar objekt me 2 kate dhe gjysmë kati nëntokë, ndërsa me formularin e vitit 2006 (datë 1.8.2006) ka vetëdeklaruar objekt 3 kate dhe gjysmë kati nëntokë. Komisioni i kërkoi subjektit të konfirmojë periudhën e ngritjes së katit të tretë (katit të fundit), duke renditur në mënyrë të detajuar dhe kronologjike punimet e kryera dhe shpenzimet e realizuara për këtë shtesë kati.

24.7.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *në lidhje me vetëdeklarimet e vitit 2005 dhe 2006, për katet e banimit, në vetëdeklarimin e datës 12.3.2005, numri i kateve mbi tokë për legalizim e ndërtesës ishte dy, pasi kati i tretë ishte vetëm në kolona në një lartësi më pak se dy metra, të cilat shërbenin për ngritjen e katit të tretë. Ndërsa në vetëdeklarimin e datës 1.8.2006 (shtojcë), ka deklaruar edhe katin e tretë për arsye se e kishte mbuluar edhe me llamarinë për të shmangur nxehtësinë që soleta lëshonte në katin e dytë. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe është konsultuar edhe me përfaqësuesit e ALUIZNI-t, të cilët i kanë kërkuar (sugjeruar) të deklaronte edhe katin e tretë, pasi ishte filluar dhe normalisht do përfundonte një ditë. Me keqardhje ka kuptuar se vetëdeklarimet ishin jo në formën më korrekte të mundshme të konstatuara nga Komisioni, por që nuk kanë patur ndonjë qëllim të caktuar për të fshehur apo përfituar nga to, por thjesht është treguar i pavëmendshëm qoftë në vetëdeklarimet për legalizimin e objektit, por edhe në deklarimet periodike vjetore.*

24.8. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

24.8.1. Pasi iu kërkuan shpjegime përfundimtare lidhur me pasaktësitë/mospërputhjet e konstatuara nga Komisioni në deklarimin e kësaj pasurie, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka sqaruar se:

a) *Në deklarimin e sipërfaqes së truallit lidhur me pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni, në matjen e saj, kanë qenë të tilla për shkak se toka, jo vetëm se nuk kishte kufizime të sakta, (qoftë me vëllezërit në dy krahët, lindje - perëndim dhe me rrugën në jug të saj, që nuk ishte përcaktuar ende gjerësia e kësaj rruge), por dhe terreni ishte i pjerrët, ku ndryshonte mënyra e matjes në raport me një sipërfaqe të sheshtë, fakt i cili është korrigjuar më vonë pas matjeve të personave specialist të fushës, e cila është pasqyruar në legalizimin e saj. Pasaktësia në matje e deklaruar, nuk ka sjellë ndonjë përfitim në legalizim, pasi autoriteti përgjegjës ishte i detyruar të bënte matjet dhe gjetjet e veta në legalizimin e saj, qoftë lidhur me truallin, po ashtu edhe me sipërfaqen ndërtimore. Baza e ndërtimit, themeli i saj prej 63 m² nuk ka ndryshuar asnjëherë, ndërsa në dy katet e tjera është shtuar sipërfaqja, me ballkonet e dala jashtë xokulaturës me rreth 1.5 metra, e barabartë me 13.5 m² për kat.*

b) *Lidhur me shpenzimet e kryera dhe burimet e krijimit të të ardhurave janë ato që ka shpjeguar edhe më parë, në pyetësorin nr. 2 dhe 3, pra, deri në vitin 2000 ka kryer aq punime sa kanë mjaftuar të ardhurat nga paga, shitja e banesës në Kukës dhe të ardhurat familjare ndër vite. Nuk ka mbajtur bilanc punimesh, pasi çdo gjë e ka bërë vetë, (pa mjete motorike përveç transportit të inerteve, hekurit dhe çimentos, pa projekt, preventiv apo situacion) dhe që nga hapja e themelit deri në katin e tretë, ku muaji qershor i vitit 2000 e ka gjetur të përshtatur për banim por jo të përfunduar. Deklarimet e viteve 2003 – 2004 janë deklarime*

pa një përlllogaritje të investimit, kjo bazuar gjithmonë tek investimi familjar. Për këtë arsye, nuk ka mbajtur asnjë dokument, sepse çdo gjë është bërë privatisht nga familjarët, njerëz të afërm, duke gjetur bazën materiale prej tyre të gatshme, vetëm se e ka vënë në punë, pra, ka organizuar forcat. Të gjitha punimet para vitit 2000 që nga themeli i ka kryer me njerëzit e tij, familjarë dhe të afërt me kontribut vullnetar.

24.9. Analiza e kryer/vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me pasaktësitë apo mospërputhjet e konstatuara në deklarin e kësaj pasurie

24.9.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti me deklaratën “Vetting” në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, konstatohet se për këtë pasuri subjekti ka paraqitur si dokumentacion justifikues ligjor (aneks *** pjesë e dosjes së ILDKPKI-së) kopje të certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar më 12.11.2015, në të cilën pasqyrohet fakti se ai është pronar i pasurisë me nr. ***, lloji i pasurisë “truall”, me sipërfaqe 514.7 m², nga kjo, ndërtesë me sipërfaqe 63 m².

24.9.2. Pra, duket se në deklarin e kësaj pasurie të bërë në “Vetting” subjekti është bazuar tek ky dokument, duke deklaruar sipërfaqen totale të truallit dhe sipërfaqen e bazës së ndërtimit. Ndërkohë, vërehet se në deklarin e bëra në organet shtetërore (Komunën ***, Drejtorinë e ALUIZNI-t) subjekti ka pasqyruar objektin dhe katet e tij në gjendjen që ndodheshin sipas viteve të deklarin.

24.9.3. Në këtë kuptim, për sa kohë ky objekt është informal, i vetëdeklaruar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit, si në ILDKPKI, po ashtu edhe për efekt legalizimi, si edhe tashmë është i legalizuar dhe i regjistruar në regjistrat hipotekorë, trupi gjykues vlerëson se pasaktësia në deklarin e të dhënave të plota të tij në deklaratën “Vetting” duket të jetë e paqëllishme, pasi, në asnjë rast nuk mund sillte pasoja në verifikimin dhe vlerësimin e kësaj pasurie nga Komisioni, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

24.9.4. Gjithashtu, trupi gjykues i çmon bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me pasaktësitë e deklarin të sipërfaqes së objektit ndër vite, në kushtet kur kemi të bëjmë me vetëdeklarin të një personi, i cili nuk ka njohuri të posaçme në fushën inxhinierike, si edhe duke marrë në konsideratë faktin se, gjithsesi, në përfundim, specialistët e ALUZINI-t do kryenin matjet përfundimtare.

24.9.5. Në këtë këndvështrim, Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklarin e të dhënave të këtij objekti janë pa pasoja dhe, si të tilla, nuk janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

24.9.6. Trupi gjykues çmon se për efekt të procesit të rivlerësimit, me rëndësi, në këtë rast, është cilësimi i periudhës së ndërtimit të këtij objekti – ecuria dhe vlera e punimeve, si edhe verifikimi i ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, të cilat janë deklaruar apo kanë shërbyer për ndërtimin e tij.

24.9.7. Si rrjedhim, Komisioni u përqendrua në analizimin e ecurisë së punimeve për ndërtimin e këtij objekti dhe koston e punimeve të kryera ndër vite.

24.10. Analiza e kryer nga Komisioni lidhur me periudhën/kronologjinë e ndërtimit dhe koston e ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi

24.10.1. Nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, deklarimeve të bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, si edhe deklarimeve të bëra në Komision në kuadër të këtij procesi administrativ, duket se, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar/dokumentuar kohën e saktë të fillimit të punimeve për këtë objekt, ecurinë e tyre (volumin e punimeve të realizuara) si edhe shumën e shpenzuar në mënyrë periodike për ndërtimin e këtij objekti, vlerën e shpenzuar deri në vitin 2000 (vit për të cilin në deklaratën

“Vetting”, ka deklaruar se ky objekt ka përfunduar pjesërisht), shpenzimet e kryera/kosto e ndërtimit deri në datën 31.12.2003, në vitin 2004 e në vijim deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

24.10.2. Në mungesë të dokumentacionit ligjor preventiv/situacione punimesh/fatura tatimore për ndërtimin e objektit “godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë”, Komisioni rezervoi të drejtën të përlllogarisë vlerën e këtij ndërtimi, si edhe ecurinë e punimeve për ndërtimin e tij deri në gjendjen aktuale, bazuar në: (i) Vendimet e Këshillit të Ministrave të nxjerra ndër vite me objekt miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave etj.; (ii) deklaratimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI dhe pranë këtij Komisioni, si dhe vlerësimin e tyre në harmoni me vetëdeklarimet e bëra dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti në organet shtetërore për këtë pasuri.

24.10.3. Në vijim të analizimit të vlerës së ndërtimit të këtij objekti në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të ndodhur në ***, konstatohet se, referuar Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 5.1.1998; nr. 214, datë 28.4.1999 dhe nr. 362, datë 14.7.2000 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ”k”, kostoja mesatare vjetore në shkallë republike e ndërtimit të banesave për vitet 1996 - 1997 është 19,581 lekë/ m² sipërfaqe banimi/shfrytëzimi, për vitet 1998 dhe 1999 është 27,878 lekë/ m² sipërfaqe shfrytëzimi dhe për vitin 2000 është 29,201 lekë/ m² sipërfaqe shfrytëzimi.

24.10.4. Nga vlerësimi i të dhënave përfituara nga vendimet e mësipërme, duket se, kostoja mesatare e ndërtimit për periudhën 1996 – 2000, është 24,823.8 lekë/ m² sipërfaqe shfrytëzimi. Në këtë kuptim, duke vlerësuar faktin se këto vendime referojnë ndërtime të kryera nga subjekte ndërtuese të licencuara, të cilat deklarojnë punimet e kryera dhe paguajnë detyrimet tatimore, si edhe nisur fakti se subjekti pretendon se ky objekt është ndërtuar në rrugë informale nga subjekte informale të palicencuar, Komisioni, paraprakisht, vlerësoi që nga kostoja mesatare e ndërtimit për metër katror, të zbrësë vlerën e tatimit mbi vlerën e shtuar, duke e përlllogaritur koston mesatare të ndërtimit për këtë periudhë në vlerën 21,121 lekë për metër katror.

24.10.5. Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit, të parashtruara me prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit, se disa materiale që kanë shërbyer për ndërtimin e pasurisë objekt vlerësimi i janë marrë të afërmeve/familjarëve të tij dhe se punimet për këtë objekt janë kryer nga ai dhe të afërmit/familjarët të tij pa pagesë, trupi gjykues çmon se këto pretendime mbeten të karakterit deklarativ dhe si rrjedhojë, nuk mund të merren në konsideratë në vlerësimin e koston së ndërtimit të kësaj pasurie.

24.10.6. Nga verifikimi i kartelës së pasurisë së këtij objekti “godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë”, rezulton se bodrumi është me sipërfaqe 63 m², kati përdhe me sipërfaqe 63 m², kati i parë sipërfaqe 81 m², dhe kati i dytë 76,5 m².

24.10.7. Referuar vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti në organet shtetërore si edhe pranë Komisionit në kuadër të hetimit administrativ lidhur me ecurinë e punimeve të këtij objekti, Komisioni vlerësoi se deri në muajin qershor të vitit 2000 (moment në të cilin rezulton posedimi i kësaj pasurie nga subjekti dhe është vetëdeklaruar si kohë e ndërtimit të objektit me 2 kate mbi tokë dhe gjysmë kati nëntokë), sipërfaqja e ndërtimit të përfunduar deri në datën 15.6.2000 është në total 207 m².

24.10.8. Pas zbatimit të çmimit mesatar të koston së ndërtimit për metër katror, të vlerësuar nga Komisioni, (referoju paragrafëve 24.10.3 dhe 24.10.4. më sipër) rezulton se, vlera e ndërtimit (kostoja e ndërtimit) të këtij objekti deri në qershor të vitit 2000 përlllogaritet në shumën **4,372,047 lekë** (207 m² x 21,121 lekë/m²).

24.11. Analiza e të ardhurave, të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie

24.11.1. Sikurse u shpreh më sipër, në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie: (i) të ardhurat nga shitja e banesës në Kukës; si edhe (ii) të ardhurat nga pagat ndër vite. Ndërsa, në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, të cilat kanë mbuluar kostot e ndërtimit, të ardhurat familjare.

24.11.2. Komisioni kreu hetim lidhur me origjinën e pasurisë së llojit “apartament banimi”, të ndodhur në Kukës, shitur nga subjekti i rivlerësimit në datën 12.10.2000 (të ardhurat nga shitja e së cilës janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi).

24.11.3. Sipas referencës së plotë të kësaj pasurie nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kukës¹¹, rezulton se në datën 28.2.1997, subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë apartament për shumën 970,000 lekë.

24.11.4. Për të provuar mundësinë financiare të blerjes së kësaj pasurie në vitin 1997, Komisioni verifikoi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën nga muaji qershor 1992 deri më 28.2.1997 (data e blerjes së pasurisë), nga ku rezultoi se të ardhurat totale të provuara me dokumentacion justifikues ligjor të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për këtë periudhë janë në shumën 935,923 lekë.

24.11.5. Komisioni vlerëson se këto të ardhura, në rastin më të mirë, janë të mjaftueshme vetëm për të përballuar shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të (familje me 5 anëtarë) për këtë periudhë (qershor 1992 – shkurt 1997) dhe se nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e ndonjë shume të kursyer deri në momentin e blerjes së kësaj pasurie.

24.12. Nga analiza e të dhënave të mësipërme, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit të banimit në shkurt të vitit 1997. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni.

24.13. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

24.13.1. Me shpjegimet e dhëna nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar se nuk ka paguar asnjë vlerë monetare për blerjen e kësaj pasurie, duke parashtruar se objekti në të cilin ndodhet ky apartament *ishte ndërtuar me kontribut vullnetar për ish-punonjësit e Minierës së Bakrit Gjegjan, Kukës, në adresën e cituar në aktin e shitjes ku përfitues i saj (kjo sipas listës së vetë kësaj ndërmarrjeje) ishte shtetasi M.J. Me këtë të fundit, në vitin 1995, në marrëveshje të pashkruar, me mirëbesim, kanë rënë dakord për të shkëmbyer banesat e tyre, konkretisht, banesën e tij private, e cila ndodhej në fshatin periferik të qytetit të Kukësit, i quajtur Gostil, (ish -NB Kukës, rreth 3 km larg qytetit Kukës), për të cilën nuk dispononte asnjë dokument ligjor për të, pasi ai, së bashku me familjen e tij e kishin përfituar si ish-punonjës të Ndërmarrjes Bujqësore Kukës...Në vitin 1997, edhe për shkak të gjendjes së krijuar, jo vetëm në Kukës, por në shkallë vendi, i ka kërkuar shtetasit M.J., me insistim, të bënim një kontratë formale shitjeje, duke i vënë vlerën që kishin banesat në atë periudhë, madje banesa e tij ishte përveçse njëkatëshe, edhe më e madhe në sipërfaqe (rreth 100 m²) që përmbushte kërkesat e shtetasit M.J.*

24.13.2. Në vijim të shpjegimeve, subjekti deklaroi se në kohën që ka bërë aktin e shitjes, shtetasi M.J., nuk ishte pronar i ligjshëm i këtij objekti, por ishte në listën e personave përfitues të Minierës së Bakrit Kukës, ku ai kishte punuar prej vitesh. Jo vetëm kjo banesë, por i gjithë pallati prej 30 hyrjesh, ishte ndarë sipas tyre me komision nga vetë ndërmarrja, me short ndërmjet punonjësve të saj, duke caktuar dhe hyrjet respektive për çdo familje përfituese. Po

¹¹ Shkresa *** prot., datë 12.8.2020.

t'i referohemi anës formale të kontratës së shitjes së datës 28.2.1997, ajo duket se nuk ka të dhëna urbanistike të objektit, por është përpiluar thjesht bazuar në deklaratimet mes shitësit e blerësit, pra, është tip marrëveshjeje mes palëve për të bërë të mundur regjistrimin e saj në hipotekë dhe njohur si objekt në pronësi. Ky fakt është konfirmuar, duke u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës më 4.3.1997, (zyrë e cila sapo ishte hapur në ambientet e Gjykatës së Rrethit Kukës), duke u ligjëruar si pronë, (në emër të shitësit M.J.), porse nuk ka dhënë asnjë shumë monetare në cash apo formë tjetër shpërblimi. Në të njëjtën gjendje ishte edhe banesa që i kishte dhënë këtij shtetasi, në fshatin Gostil, në të cilin kishte banuar prej më shumë 20 vite. Referuar kartelës së transaksionit të pasurisë (të cilën deklaroi se do e paraqesë si provë) të këtij objekti duket qartë se shtetasi M.J., është bërë pronar i këtij objekti ligjërisht më 12.10.2000, në të njëjtën datë që kanë bërë edhe aktin, kontratë shitblerjeje aparatamenti, ku është paguar prej tij edhe vlera 3,190 lekë në favor të Entit të Banësve për llogari të shtetasit përfitues M.J. Pra, vetëm pas pagesës së kësaj shume, ai është bërë pronar i banesës që kishte marrë prej tij që në vitin 1995 edhe pse kishin realizuar kontratën e shitjes në vitin 1997, pa qenë në rolin e pronarit të ligjshëm.

24.13.3. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti i rivlerësimit ka depozituar si prova dokumentet si vijon: (i) deklaratën noteriale të datës 27.10.2020, të trashëgimtarit të shtetasit M.J., (ndërruar jetë në qershor të vitit 2020), të të birit, shtetasit G.J.,¹²; dhe (ii) vendimin për lëshimin e dëshmisë të trashëgimisë ligjore¹³ datë 15.6.2020; dhe (iii) kopje të kartelës së kësaj pasurie.

24.14. Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

24.14.1. Nga vlerësimi i shjegimeve të dhëna nga subjekti me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, lidhur me transaksionin e kryer për përfitimin e kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se ato nuk duken bindëse, pasi janë tërësisht të karakterit deklarativ. Subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi asnjë dokument provues për marrëdhënien e pronësisë apo përdorimit të pasurisë së pretenduar prej tij, banesë private në fshatin Gostil, Kukës.

24.14.2. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kukës¹⁴, rezulton se bazuar në kontratën e shitjes së datës 28.2.1997, pasuria e sipërcituar në datë 4.3.1997 është regjistruar në regjistrin e hipotekës së Rrethit Kukës me nr. ***, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

24.15 Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë dhe se ai nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nga analiza e kryer si më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit të banimit në shkurt të vitit 1997.

24.16. Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Kukës, deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi

24.16.1. Referuar kontratës së shitblerjes së apartamentit¹⁵, datë 12.10.2000, subjekti i rivlerësimit ka shitur pasurinë e llojit “apartament banimi”, të përbërë nga 2 dhoma dhe 1 kuzhinë, me sipërfaqe banimi 74 m², i ndodhur në lagjen nr. ***, ***, Kukës, kundrejt vlerës 600,000 lekë.

24.16.2. Për efekt të analizës financiare, Komisioni paraprakisht vlerësoi se kjo vlerë e dokumentuar si e përfituar në tetor të vitit 2000, nuk do të konsiderohet se ka shërbyer si burim krijimi i ndërtimit (ndërtimi i pjesshëm deri në qershor të vitit 2000) të objektit në ***,

¹² Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2020.

¹³ Dokumenti noterial, vendim “Dëshmi trashëgimie ligjore” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.9.2020.

¹⁴ Shkresa *** prot., datë 12.8.2020.

¹⁵ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2000 – ndodhur Aneks *** në dosjen e ILDKPKI.

vetëdeklaruar në formularin e parë vetëdeklarim për legalizim të datës 12.3.2005 si i ndërtuar në datë 15.6.2000. Kjo, duke marrë në konsideratë edhe faktin se në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në qershor të vitit 2000, është shpërngulur me familjen nga Kukësi për të jetuar në banesën në ***, të cilën e kishte bërë të përshtatshme për shfrytëzim.

24.17. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

24.17.1. Pas kalimit të barrës së provës, lidhur me shitjen e kësaj banese me dërgimin e prapësimeve subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se z. N.P., (blerësi) dhe familja e tij kanë lidhje të afërta familjare, pasi bashkëshortja e tij dhe bashkëshortja e subjektit janë kushërira të para (baballarët vëllezër). Duke qenë në këtë lidhje, kanë rënë dakord kohë më parë për shitjen e këtij apartamenti. Në vitin 1996 kanë bërë marrëveshjen për shitjen e apartamentit kundrejt vlerës prej 600,000 lekë dhe një autoveture të markës “Volkswagen”, tip “Golf II”, me vlerë rreth 400,000 lekë, duke e konsideruar shitjen e apartamenti afërsisht me vlerë 1,000,000 lekë. Gjithashtu, pjesë e kësaj marrëveshjeje, ishte qëndrimi i tij në atë apartament deri në momentin e përfundimit pjesërisht të ndërtimit të banesës që kishte filluar të ndëronte në Tiranë, për të cilën i ka kërkuar z. N.P., si kusht, që likuidimin e vlerës prej 600,000 lekësh, t’ia jepte me këste paraprake sipas nevojës me qëllim investimin prej tij në ndërtimin e saj. Pasi i është likuiduar e gjithë shuma sipas marrëveshjes deri në vitin 2000, është finalizuar edhe nënshkrimi i kontratës së shitjes së datës 12.10.2000. Pra, e gjithë shuma e pasqyruar në aktin e shitjes është likuiduar shumë kohë më parë dhe është investuar në banesën që kishte filluar të ndëronte në Tiranë para vitit 2000, kohë në të cilën është përpiluar akti i shitjes. Madje kontrata e shitjes mes tij dhe shtetasit N.P., është bërë rreth 4 muaj pasi është zhvendosur me familjen në Tiranë, për shkak të përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimit nga Enti Banesa Kukës për këtë objekt, si dhe njohjen si pronar i parë i legjitimuar, të shtetasit M. J.

24.17.2. Në vijim, subjekti ka parashtruar se po t’i referohemi kartelës së transaksionit të pasurisë (depozituar si provë), të ZRPP-së Kukës, të kësaj banese, rezulton se në të njëjtën datë, pra, 12.10.2000, është bërë pronar shitësi i parë M.J., ku edhe është paguar shuma 3,190 lekë. Në të njëjtën datë 12.10.2000 i ka kaluar atij pronësia dhe të nesërmen me 13.10.2000 është shitur prej tij dhe i ka kaluar blerësit N.P., edhe pse detyrimet ish-in përmbushur kohë më parë nga palët në mirëbesim.

24.18. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

24.18.1. Komisioni vëren se lidhur me transaksionet e kryera për këtë pasuri, subjekti ka pretenduar se e gjithë marrëdhënia e tij në përfitimin e kësaj banese (pretenduar me shkëmbim), si edhe shitjes së saj, është kryer në kushtet e mirëbesimit, gjë që e dëshmon fakti, se sipas pretendimeve të tij, ai është bërë pronar i kësaj pasurie në datën 12.10.2000, duke referuar si indicie shënimet e bëra në kartelën e kësaj pasurie për datën e regjistrimit në emër të subjektit të rivlerësimit; depozituar si provë kopje e kartelës së kësaj pasurie.

24.18.2. Në nenin 164 të Kodit Civil është parashikuar si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë – nëpërmjet kontratës, ndërsa në nenin 83 të Kodit Civil përcaktohet se veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm.

24.18.3. Referuar nenit 192 të Kodit Civil, sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

24.18.4. Gjithashtu, në nenin 193 të këtij Kodi përcaktohet se kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

24.18.5. Siç u vu në dukje më sipër, me kontratën e datës 28.2.1997 (konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.2.1997), subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri nga shtetasi M.J., për vlerën 970,000 lekë. Bazuar në këtë kontratë, në datën 4.3.1997 kjo pasuri, e llojit “apartament banimi” është regjistruar në regjistrin e hipotekës Kukës në emër të subjektit të rivlerësimit.

24.18.6. Pra, nga vlerësimi provave të administruara në dosje lidhur me këtë pasuri – në harmoni me kuadrin ligjor që rregullon fitimin e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme dhe regjistrimin e tyre – Komisioni krijoi bindjen se kjo pasuri është fituar ligjërisht nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 1997, me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes dhe regjistrimin e saj në regjistrin e hipotekës së Rrethit Kukës.

24.18.7. Për më tepër, Komisioni çmon se me rëndësi për efekt të këtij procesi është verifikimi i parashikimeve të bëra në kontratat respektive lidhur me çmimin e shitblerjes së kësaj pasurie dhe planin e pagesave.

Neni 659 i Kodit Civil parashikon se “*Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike*”.

Neni 660 i Kodit Civil parashikon se: “*Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi*”.

Neni 663 i Kodit Civil përcakton kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: “*Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji*”.

Ndërsa neni 690 i Kodit Civil parashikon se: “**Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët.** Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

24.18.1. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i lirë të përcaktojë përmbajtjen e kontratave në bashkëpunim me palën tjetër nënshkruese, Komisioni vlerëson se, qoftë kontrata e blerjes (analizuar më sipër), po ashtu dhe ajo e shitjes së kësaj pasurie, pasqyrojnë rrethanat e vërteta lidhur me situatën faktike të realizimit të këtyre transaksioneve. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se mbeten të paprovuara, të karakterit deklarativ, pretendimet e subjektit se ka marrë paraprakisht shumë prej 600,000 lekësh nga shitja e apartamentit në Kukës.

24.18.1. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit, se si pjesë e marrëveshjes për shitjen prej tij të apartamentit në Kukës është kalimi në favor të tij i automjetit të markës “Volkswagen”, tip “Golf II”, me vlerë rreth 400,000 lekë, për të cilin deklaroi se e ka shitur në vlerën prej 350,000 lekë në vitin 2000. Shpjegimet e subjektit lidhur me këtë rrethanë të pretenduar janë të karakterit deklarativ, pasi ai nuk depozitoi dokumentacion për këtë automjet për të provuar si blerjen, ashtu dhe shitjen e tij.

24.19. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për të mbuluar shpenzimet/investimin e kryer në pasurinë objekt vlerësimi (banesës në ***) deri në datën 15.6.2000.

24.20. Verifikimi i të ardhurave të përfituara nga pagat ndër vite, deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi

24.20.1. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit deri në datën e deklaruar të ndërtimit të banesës (data 15.6.2000 përcaktuar në vetëdeklarimin për legalizim të datës 12.3.2005), referuar vërtetimit të

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës¹⁶ rezulton se të ardhurat totale të subjektit të rivlerësimit për periudhën 26.5.1992 – qershor 2000, janë rreth 2,344,798 lekë.

24.20.2. Për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, pjesë e të njëjtit trung familjar, nuk referohen të dhëna punësimi. Vetëm nëna e subjektit të rivlerësimit (pjesë e trungut familjar) sipas vërtetimit të lëshuar nga DRSSH-ja Kukës, konstatohet se është trajtuar me pension familjar nga data 14.8.1986 dhe se deri në qershor të vitit 2000 ka përfituar të ardhura në vlerën rreth 180,000 lekë.

24.21. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se *truallin e banesës së sipërcituar ia kanë dhënë vëllezërit e tij në vitin 1996, kundrejt vlerës 50,000 lekë, të cilën sipas tyre e kishin blerë më parë nga shtetasi E.D., në shumën prej 200,000 lekë, pa dokumente, e gjetur e lirë, pa pronarë të ligjshëm dhe kështu ishte, pasi, anjehere nuk ka ardhur njeri të ankohet lidhur me vendin në të cilin kanë ndërtuar ai dhe vëllezërit e tij.*

24.21.1. Bazuar në vetëdeklarimin e subjektit, në analizën financiare për mundësinë e kryerjes së investimit deri në datë 15.6.2000 për pasurinë objekt vlerësimi, Komisioni do të përfshijë si shpenzim edhe shumën prej 50,000 lekë - si çmim i paguar për truallin ku është ndërtuar kjo banesë.

24.22. Gjithashtu, po në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se, *automjeti me targë TR *** (deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë), është blerë në vitin 2003 në vlerë 500,000 lekë, me të ardhurat nga shitja e automjetit të markës “Mercedes Benz”, me targë TR ***, në shumën prej 300,000 lekë. Pas kërkesës së Komisionit, DPSHTRR-ja¹⁷, pavarësisht konfirmimit me shkresë për mjetin me targë TR ***, nuk i ka bashkëlidhur dosjen e tij.*

24.22.1. Në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, me qëllim saktësimin e periudhës dhe çmimit të shitblerjes së autovecurës me targë TR ***, Komisioni kërkoi¹⁸ sërish dosjen e plotë të këtij mjeti. Referuar dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja¹⁹ për automjetin me targë TR ***, rezulton se ky mjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 21.2.2000 për vlerën 450,000 lekë dhe, si rrjedhim, ky send dhe vlera e tij do të përfshihet në analizën financiare për mundësinë e kryerjes së investimit deri në datën 15.6.2000 për pasurinë objekt vlerësimi.

24.22.2. Por, nga verifikimi i materialeve të dosjes së dërguar, konstatohet se mbasi është bërë çregjistrimi për efekt transferimi të këtij automjeti nga DRSHTRR-ja Kukës (i cili më parë ka mbajtur targën KU ***) dhe regjistrimin e tij në DRSHTRR-në Tiranë në vitin 2001 (me targa TR ***) nuk gjenden të dhëna të tjera lidhur me këtë automjet.

24.22.3. Sa më sipër, nuk provohet shitja e mjetit me targa TR *** dhe përfitimi i të ardhurave në shumën 300,000 lekë, sipas vetëdeklarimit të subjektit përcaktuar si çmim i shitjes së këtij automjeti.

24.22.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar depozitim të dokumentacionit justifikues ligjor, ku të provohet shitja e këtij automjeti dhe përfitimi i të ardhurave të vetëdeklaruar prej tij.

24.22.5. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *ky automjet i është shitur shtetasit D.D., në vitin 2003, në vlerën 300,000 lekë dhe se është mbajtur nga ky shtetas me prokurë të posaçme përdorimi dhe të drejtë shitjeje deri në vitin 2006 dhe pastaj e ka shitur. Duke qenë se ishte familjar i tij (nipi, djali i vëllait) këtë automjet ia ka shitur në kushte mirëbesimi si dhe duke neglizhuar formalizimin e kontratës së shitjes.*

¹⁶ Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016 – ndodhur ankes *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 13.8.2020.

¹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 13.10.2020.

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2020.

24.22.6. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka depozituar si provë deklaratën noteriale të datës 27.10.2020, të shtetasit D.D.

24.23. Trupi gjykues vlerëson se mbeten të karakterit deklarativ, të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor, pretendimet e subjektit për përfitimin e të ardhurave nga shitja e këtij automjeti në vitin 2003, në shumën 300,000 lekë.

24.24. Ndërsa shpenzimet jetike të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit, e përbërë nga 5 anëtarë për periudhën maj 1992 – qershor 2000, nga Komisioni janë përlllogaritur në shumën 2,260,000 lekë. Në këto shpenzime nuk janë përfshirë shpenzimet e nënës së subjektit, pjesë e të njëjtit trung familjar, të cilat çmohen se janë mbuluar nga pensioni i saj.

24.25. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe informacionin/dokumentacionin administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën **maj 1992 – qershor 2000**, për të provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e objektit në ***, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Analiza financiare deri në qershor të vitit 2000		
Nr.	Përshkrimi / Referenca	Vlerat në lekë
	Të ardhura të vërtetuara të subjektit, periudha 26.5.1992 - 06/2000	2,344,798
1.	Total të ardhura/të hyra financiare	2,344,798
	Kosto mesatare ndërtimi banesa 2+1 kate	4,372,047
	Blerje trualli viti 1996 (<i>deklaruar</i>)	50,000
	Blerje apartamenti në Kukës, në datën 28.2.1997	970,000
	Blerje automjeti i markës “Mercedes Benz” në datën 21.2.2000	450,000
	Shpenzime min. jetese 06/1992-06/2000	2,260,000
2.	Total shpenzime/të dala financiare	8,102,047
	Balanca e fondeve (1-2)	- 5,757,249

24.26. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e këtij objekti deri në qershor të vitit 2000, si edhe krijimin e pasurive të tjera dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara për këtë periudhë.

24.27. Rezulton se në deklaratën fillestare të pasurisë²⁰ krahas banesës në *** (vetëdeklaruar me vlerë 3 milion lekë) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe pasurinë e llojit “autoveturë”, të markës “Mercedes Benz”, tip “200”, me targë TR ***, me vlerë 500,000 lekë.

24.27.1. Referuar dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja²¹, ky automjet është blerë²² nga djali i subjektit të rivlerësimit, i patarguar, vetëm një ditë pas zhdoganimit të tij, në vlerën 250,000 lekë.

24.27.2. Në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *ky automjet është deklaruar në DPV-në fillestare të vitit 2003, i blerë me vlerën 500,000 lekë, për të cilin, referuar akteve ligjore të konstatuara nga Komisioni rezulton se ky automjet është blerë në vlerën 250,000 lekë, fakt i cili është i pakundërshtueshëm prej tij, pasi duke u referuar në deklarimin e vitit 2004 të shitjes së këtij mjete, për të cilin vlera ka qenë 250,000 lekë, pas përdorimit me një afat të shkurtër kohor prej afro 1 viti, duket qartë se vlera e shitjes*

²⁰ Dorëzuar nga subjekti në datë 15.3.2004 në ILDKPKI.

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 13.8.2020.

²² Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., dat 21.8.2003.

është në proporcion të drejtë me vlerën e blerjes. Në përfundim, nuk mbetet gjë tjetër përveç se të thotë se ka qenë një gabim njerëzor në deklarin e tij në DPV/2003.

24.27.3. Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti me prapësimet e dërguara gjatë rezultateve të hetimit lidhur me vlerën e këtij mjeti, bien në kundërshtim me deklarin e bëra në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nëpërmjet të cilit ka deklaruar se vlera e blerjes së këtij mjeti është 500,000 lekë. Gjithsesi, çmohet se në përputhje me qëndrimin e mbajtur në vazhdimësi nga Komisioni, vlera e blerjes së këtij mjeti është ajo e pasqyruar në kontratën e shitblerjes.

24.27.4. Gjithashtu, konstatohet se në DPV/2004 nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar në mënyrë specifike shitjen e këtij automjeti në shumën 250,000 lekë. Vërehet se në këtë DPV ka deklaruar blerjen e automjetit të markës “BMW”, me të ardhurat e krijuara nga shitja e makinës së mëparshme të djalit.

24.27.5. Por, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja²³ konfirmohet se në datën 27.1.2004, personi i lidhur – djali i subjektit – e ka shitur këtë automjet për shumën 250,000 lekë.

24.28. Duke konsideruar faktin se për periudhën qershor 2000 – 31.8.2003 (data e blerjes së këtij automjeti), nuk vërehet krijimi i ndonjë pasurie tjetër, punime të kryera/shpenzime të realizuara për ndërtimin e banesës në *** apo shpenzime të tjera në vlera të konsiderueshme, krahas shpenzimeve jetike, Komisioni vlerëson se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë (ku përfshihen edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit të Kukës²⁴) kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e këtij automjeti nga personi i lidhur.

24.29. Analiza ligjore/financiare e investimit të kryer për pasurinë objekt vlerësimi përgjatë vitit 2004, si edhe për krijimin e pasurive të tjera përgjatë këtij viti

24.29.1. Në DPV/2004 subjekti ka deklaruar se vlera e shtëpisë së banimit të ndodhur në *** është 4,000,000 lekë. Nisur nga ky vetëdeklarim i subjektit, duket se vetëm përgjatë vitit 2004 subjekti ka investuar në këtë pasuri shumën prej 1,000,000 lekësh (4,000,000 lekë deklaruar në DPV 2004 (minus) 3,000,000 lekë deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë).

24.29.2. Gjithashtu, në DPV/2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin e markës “BMW” në pronësi të djalit të tij, z. B.D., me vlerë 300,000 lekë. Ndërsa në DPV/2007, është deklaruar shitja e këtij mjeti. Por, DPSHTRR-ja²⁵ nuk ka konfirmuar këtë automjet, të cilin subjekti pretendon se ka qenë në pronësi të djalit të tij.

24.29.3. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për blerjen dhe shitjen e këtij automjeti apo të deklaronte të dhëna identifikuese të këtij mjeti, si p.sh., targën e tij. Në lidhje me këtë kërkesë të Komisionit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se²⁶ *në lidhje me automjetin tip “BMW”, të deklaruar më parë, pas verifikimeve dhe përpjekjeve të bëra prej tij për të gjetur të dhëna për këtë automjet, e dhëna e vetme që i ka rezultuar është targa e automjetit, e cila është TR ***.*

24.29.4. Ndërsa, paraprakisht në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se²⁷ *shitja e automjetit tip “BMW 524” (automjet i deklaruar në pronësi të djalit në DPV/2004) mendon se është bërë në fund të vitit 2007, me vlerë 250,000 lekë dhe se dokumentin vërtetues për shitjen e kësaj autoveture, për fat të keq, nuk e disponon.*

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 13.8.2020.

²⁴ Të ardhura këto të papërfshira në analizën financiare të kryer nga Komisioni deri në datë 15.6.2000.

²⁵ Shkresa *** prot., datë 6.2.2019.

²⁶ Përgjigjia nr. 3, e Pyetësorit nr. 3.

²⁷ Përgjigjia e pyetjes nr. 3, të Pyetësorit nr. 2.

24.29.5. Në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, bazuar në të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti, Komisioni kërkoi²⁸ nga DPSHTRR-ja dërgimin e dosjen së plotë të mjetit me targë TR ***. Pas administrimit²⁹ të dosjes së plotë, nga verifikimi i materialeve nuk rezultoi që ky mjet të ketë qenë në pronësi të djalit të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, rezultojnë disa transaksione lidhur me këtë automjet, nga ku konstatohet se në qershor të vitit 2003 është blerë nga shtetasi H.O., i cili e ka shitur në maj të vitit 2005.

24.29.6. Sa më sipër, duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri. Gjithashtu referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2004, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimin e kryer për banesën në ***, blerjen e automjetit të markës “BMW” apo kryerjen e shpenzimeve të tjera përgjatë vitit 2004.

24.29.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bërë nga Komisioni.

24.30. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

24.30.1. Në prapësimet lidhur me shitblerjen e automjetit të mësipërm konstatuar dhe argumentuar nga Komisioni si deklaram i pasaktë për këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar se *nisur nga deklaramet në pyetësin nr. 2, ku ka thënë se, “në vitin 2004 është bërë shitja e autoveturës tip “Benz” me targë TR *** me vlerë 300,000 lekë, e cila është deklaruar në DPV/2003 dhe është blerë autovetura tip “BMW 524” me vlerë 300,000 lekë po nga ky burim të ardhurash. Praktikisht është “shkëmbyer”, argumenton se, në vitin 2004 këtë automjet tip “BMW 524”, djali i tij e ka shkëmbyer me shtetasin H.O., duke i dhënë automjetin tip “Benz”, me targë TR*** pa detyrime të tjera. Në vijim të situatës, lidhur me formalizimin e aktit ligjor për shitblerjen/këmbimin e këtyre mjeteve rezultoi se në atë kohë me këtë shtetas është përpiluar akti i shitjes për automjetin tip “Benz”, me targë TR*** me vlerë 300,000 lekë (vlerë kjo referuar çmimit të tregut) që i kalon në pronësi shtetasit H.O, ndërsa akti i blerjes për automjetin tip “BMW 524, nuk është nënshkruar, pasi djali e ka përdorur këtë automjet me aktpërdorim nga ky shtetas.*

24.30.2. Në vijim, ka sqaruar se *në lidhje me shitjen e tij në vitin 2005 sipas dokumentacionit të siguruar nga ana e Komisionit rezultoi se ky automjet është shitur nga shtetasi H.O në maj të vitit 2005, për këtë fakt, thekson se ky shtetas ka bërë shitjen e këtij automjeti vetëm nga ana formale, pasi të ardhurat e krijuara për shitjen e tij kalonin për llogari të djalit të tij. Në lidhje me deklaramet në pyetësin nr. 2, për kohën në të cilën ka thënë se është shitur ky automjet (në vitin 2007), sqaron se duke ndjekur një përlllogaritje kohore të hamendësuar, ka dalë në atë përfundim që ky mjet është shitur në vitin 2007. Duke bërë korrigjimin nga ana e tij si dhe referuar edhe akteve të siguruara nga ana e Komisionit rezultoi se ky automjet është shitur në vitin 2005. Për të mbështetur pretendimet e tij, gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka depozituar si provë deklaratën noteriale³⁰ të datës 11.11.2020, të shtetasit H.O.*

24.30.3. Ndërsa lidhur me investimin e kryer në banesën e tij në *** për vitin 2004, vlerësuar nga Komisioni në shumën prej 1,000,000 lekë (duke konsideruar vetëdeklarimeve të tij të bëra ndër vite në ILDKPKI), subjekti i rivlerësimit nuk pati pretendime. Gjithashtu, subjekti nuk ngriti pretendime lidhur me aspekte/tregues të tjerë të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2004.

24.31. Analiza përfundimtare e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 13.10.2020.

²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2020.

³⁰ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2020.

24.31.1. Nga analiza e shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me transaksionet e kryera për shitblerjen e automjetit tip “BMW”, trupi gjykues vlerëson se ato janë kontradiktore dhe kryesisht të karakterit deklarativ. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e mjetit është 300,000 lekë dhe se këtë pasuri e ka shkëmbyer me mjetin e markës “Mercedez Benz”, për të cilin thotë se është bërë shitja e tij me vlerë të njëjtë në shumën 300,000 lekë. Por, nga verifikimi i kryer nga Komisioni, rezultoi se mjeti “Mercedez Benz” me targë TR ***, i është shitur shtetasit H.O., nga personi i lidhur në datën 27.1.2004 në shumën 250,000 lekë.

24.31.2. Gjithsesi, në mungesë të dokumentacionit provues për vlerën e blerjes së tij nga djali i subjektit të rivlerësimit në vitin 2004, në analizën financiare do të pasqyrohet si i blerë në shumën 300,000 lekë (bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti/personi i lidhur), ndërsa si të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit të markës “Mercedez Benz” me targë TR *** do të pasqyrohet në analizën financiare të vitit 2004 vlera 250,000 lekë, referuar kontratës së shitblerjes së këtij mjeti.

24.32. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruarra dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004, për të vënë në dukje mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për investimin e kryer, krijimin e pasurive të tjera apo kryerjen e shpenzimeve të dëshmuara/deklaruarra, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2

Analiza financiare, periudha 1.1.2004 - 31.12.2004	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimi; subjekti i rivlerësimit; dokumentuar	1,299,333
Të ardhura nga pensioni i nënës; dokumentuar	50,550
Të ardhura nga shitja e autoveturës tip “Benz” TR ***	250,000
Total të ardhura/të hyra financiare	1,599,883
Shpenzime transporti SR; deklaruar	120,000
Shpenzime minimale per konsum sipas INSTAT-it; ILDKPKI-së	563,784
Total shpenzime	683,784
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Mjete monetare të disponueshme (1)	916,099
Investim në shtëpinë 3+1 kate në *** (deklaruar)	1,000,000
Blerë autoveturë tip “BMW”; deklaruar	300,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	1,300,000
Balanca e fondeve (1-2)	- 383,901

24.33. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimin e kryer për banesën e tij në ***, blerjen e automjetit të markës “BMW” apo kryerjen e shpenzimeve të tjera përgjatë vitit 2004.

24.34. Lidhur me konstatimin e ILDKPKI-së se ndërtimi i paligjshëm i bërë nga subjekti i rivlerësimit bie ndesh me nenin 199/a të Kodit Penal, Komisioni konstaton se kjo vepër është parashikuar për herë të parë në Kodin Penal, të miratuar me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës Shqipërisë”, si rrjedhim, duke marrë në konsideratë faktin se referuar vetëdeklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar në dosje, ky objekt ka filluar të ndërtohet në vitin 1996/përfunduar pjesërisht në vitin 2000 dhe aplikimi për legalizim është bërë në vitin 2006, nuk mund të jetë kjo dispozita e zbatueshme në këtë rast.

24.35. Gjithsesi, duket se zënia e truallit mbi të cilin është bërë ky ndërtim (truall i cili nuk ishte në pronësi të subjektit të rivlerësimit) kryer në vitin 1996 nga subjekti i rivlerësimit, përbënte kundërvajtje penale dhe binte ndesh me nenin 200 të Kodit Penal “Pushtimi i tokës”. Gjithashtu, ndërtim i kryer nga subjekti i filluar në vitin 1996, përbënte kundërvajtje administrative dhe binte ndesh me kërkesat e nenit 28 të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993 “Për urbanistikën”, i cili përcaktonte se, *...çdo person fizik e juridik, vendas apo i huaj që do të ndërtojë duhet të pajiset me leje ndërtimi, e cila është dokumenti ligjor që lejon piketimin e objektit. Piketimi bëhet nga zyra e urbanistikës në bashki e komunë ose nga persona të autorizuar prej tyre.*

24.36. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

24.36.1. Pasi iu kërkuan shpjegime përfundimtare lidhur me konstatimet e mësipërme, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se *vërtet për një prokuror është e rëndë të shkojë të kapë një tokë, një truall diku tjetër në mënyrë të paligjshme, por ka shpjeguar se, trualli për ndërtim prej 2000 m², i ndarë nga 500 m² për familje është siguruar nga vëllezërit e mi që në vitin 1995, të cilët ia kanë blerë shtetasit E.D., (i vetëquajtur pronar) në shumën 200 mijë lekë, pa dokument, por që janë siguruar prej tij se kjo parcelë nuk ka probleme ligjore dhe se pronari i saj është i larguar prej shumë vitesh jashtë Shqipërie dhe për këtë përgjigjet vetë ai. Në këto kushte kjo parcelë shumë në periferi të Tiranës, në atë kohë, u është dukur e përshtatshme për të ndërtuar dhe filluar një jetë të re, të diktuar nga kushtet e krijuar të tranzicionit. Ata janë përkrahur e mbështetur nga autoritet vendore të kësaj zone (***) ku janë trajtuar edhe me ndihmë humanitare dhe përkrahje sociale, duke ligjëruar në një farë mënyre, jo vetëm lëvizjen e tyre, por edhe vijimin e ndërtimit. Të tre vëllezërit e tij ishin të detyruar të largoheshin nga trojet e tyre të siguruara nga ish-NB Kukës, pasi ish- pronarët e këtyre trojeve iu kishin vënë kushte dhe kufizime të tilla që ata të largoheshin sa më parë, ku toka e pretenduar si pronë shteti tashmë kërkohej nga pronarët e tyre, madje deri në ushtrim dhune. Në vijim, ka shpjeguar se edhe ai si pjesë përbërëse e këtij trangu familjar, është bërë pjesë e këtij procesi tranzicioni në dukje i paligjshëm, por që kishte mbështetje të madhe, qoftë politike dhe shtetërore në atë periudhë, fakt i cili vetë shteti u detyrua të ligjëronte çdo gjë që vetë kishte ushqyer në atë kohë, duke legalizuar informalitetin në vendin tonë, jo vetëm në Tiranë, por në gjithë vendin. Pra, nuk mendon se ky veprim duhet të konsiderohet vepër penale, kur paligjshmëria udhëhiqet nga vetë shteti, pavarësisht legjislacionit të kohës që parashikonte sanksione për këto veprime.*

24.36.2. Vlen të theksohet se gjatë seancës dëgjimore, pasi subjekti dha shpjegimet e tij lidhur me zënien e truallit dhe ndërtimin pa leje, ka mbajtur qëndrimin se Komisioni ka qenë shumë i saktë, shumë korrekt, shumë i rregullt dhe se s’ka asnjë vërejtje për procesin e kryer ndaj tij.

24.37. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

24.37.1. Komisioni vlerëson se zënia e truallit dhe ndërtimi i paligjshëm i kryer nuk përputhen me etikën e prokurorit dhe e cenon atë, por, nga ana tjetër, pasi analizoi me paanësi dhe objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në raport me kohën në të cilën janë kryer këto veprime, në kushtet e tranzicionit të thellë që po kalonte shteti shqiptar dhe faktit të njohur botërisht të imigrimit të brendshëm për shkak të kushteve social - ekonomike të disa zonave të Shqipërisë, si edhe në kushtet kur në atë kohë nuk ishte kryer/rregulluar ndarja e saktë e titujve të pronësisë, Komisioni arrin në konkluzionin se kjo shkelje nuk mund të përbëjë veçmas shkak për shkarkimin e subjektit dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar.

24.37.2. Në arritjen e përfundimit të mësipërm, Komisioni vlerësoi korrektësinë në qëndrimin e mbajtur nga subjekti, i cili e ka pranuar faktin, në harmoni me politikat shtetërore dhe aktet

ligjore të nxjerra në vijim, të cilat kanë legalizuar këto pasuri, duke formalizuar të gjitha veprimet e kryera për krijimin e tyre. Gjithashtu, i rëndësishëm është fakti se Komisioni nuk ka asnjë të dhënë/indicie, referuar së cilës trualli i zënë të jetë kërkuar të kthehet, qoftë kjo në rrugë administrative apo gjyqësore. Pra, duket se pas zënies së truallit, subjekti e ka poseduar qetësisht atë deri në momentin e legalizimit të tij.

❖ Pasuritë e deklaruara veçmas nga djali i subjektit, B.D.,

25. Pasuria e llojit “autoveturë”³¹, marka “Renault” e vitit 2003, me targë AA *, blerë në datën 19.7.2012, me vlerë 4,600 euro. Zotëron 100% të kësaj pasurie.**

25.1. Si burim krijimi ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja për pjesë këmbimi e autoveturës tip “Toyota” me targë TR ***, në vlerën 2,000 euro; dhe (ii) hua nga të afërmit në vlerën 2,600 euro.

25.2. Në rubrikën e veçantë të deklaratës “Vetting”, subjekti/personi i lidhur ka deklaruar se automjeti i markës “Renault” me targë AA ***, i vitit 2003, është blerë në datën 19.7.2012, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol.

25.2. Konkluzionet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

(i) Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me shumën prej 2,600 euro deklaruar marrë hua të afërmeve;

(ii) Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me shitjen për pjesë të automjetit të markës “Toyota”, në shumën prej 2,000 euro;

(iii) Nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2012, blerjen e automjetit tip “Renault”, sipas kontratës datë 19.7.2012, në shumën 4,600 euro. (ky automjet është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2015).

25.3. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

25.3.1. Referuar DPV/2015, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar pasurinë e llojit “autoveturë” “Renault” e vitit 2003, me targë AA ***, blerë në datë 19.7.2012, me vlerë 4,600 euro. Si burim krijimi ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të markës “Toyota”, me targë TR ***, në vlerën 2,000 euro; dhe (ii) hua nga të afërmit, vlerën 2,600 euro.

25.3.2. Ndërsa, në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme, të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar se kjo pasuri është blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2012.

25.4. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

25.4.1. DPSHTRR-ja³² konfirmon se personi i lidhur, B.D., ka në pronësi mjetin me targë AA ***. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti konstatohet se në datë 19.7.2012, personi i lidhur ka blerë³³ pasurinë e llojit “autoveturë”, të markës “Renault”, tipi “Megane Scenic JM”, me targë KB-***, vit prodhimi 2003, për vlerën prej 4,600 euro.

25.4.2. Gjithashtu, rezulton se ky mjet është zhdoganuar në datën 6.7.2012 dhe në bazë të deklaratës doganore, pjesë e dosjes, baza e taksueshme/vlera e përllogaritur për zhdoganimin e këtij mjeti është 159,586 lekë, detyrimet e paguara në vlerën prej 31,916 lekë dhe se, procedurat e zhdoganimit janë kryer nga shitësi, shtetasi E.H.

³¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2012.

³² Shkresat nr. *** prot., datë 6.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 12.12.2019.

³³ Kontrata e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2012.

25.4.3. Nga analiza e të dhënave të mësipërme, verifikimit të vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti/personi i lidhur ndër vite në ILDKPKI dhe dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja lidhur me këtë pasuri, konstatohet se:

i) Megjithëse kjo pasuri është blerë në vitin 2012, nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore të viteve 2012, 2013 dhe 2014. Gjithashtu, në këto DPV nuk është deklaruar shuma prej 2,600 euro, pretenduar si e marrë hua nga të afërmit në vitin 2012. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2015.

ii) Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar shitjen për pjesë këmbimi të autoveturës “Toyota”, si edhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimeve të huadhënësit për huan e pretenduar.

25.4.4. I pyetur nga Komisioni lidhur me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se³⁴ *deklarimin e automjetit tip “Toyota” me targë TR *** nuk e ka bërë për arsye se nuk ka patur dijeni që djali e dispononte këtë mjet në emër të tij, duke marrë parasysh që ai punonte në një servis makinash dhe herë pas herë lëvizte me makina të punës së tij apo të miqve të tij. Pas deklarimit të DPV/2014, kuptoi se automjeti ishte në pronësi të djalit dhe se burimi i të ardhurave që djali kishte përdorur për blerjen e këtij automjeti ishte: (1) nga shitja në vlerë cash (2,000 euro) e automjetit tip “Toyota” me targë TR *** për pjesë këmbimi dhe (2) huamarrje pa aftat të caktuar në vlerën 2,600 euro nga daja i djalit (A.O.), i cili jeton dhe punon në Itali.*

25.4.5. Nga verifikimi i sistemit TIMS, duket se subjekti e ka përdorur këtë mjet (automjetin e markës “Toyota”) që në vitin 2007, gjatë kalimit të pikave kufitare, automjet i cili më parë ka mbajtur targën SH ***.

25.4.6. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti rezulton se në datën 26.2.2008, djali i subjektit të rivlerësimit e ka blerë³⁵ këtë automjet nga shtetasja L.K., për vlerën 250,000 lekë, kontratë e redaktuar nga noteri publik z. A.K., pjesë e Dhomës së Noterisë Shkodër.

25.4.7. Gjithashtu, pasi Komisioni kërkoi nga subjekti shpjegime për mjetet e përdorura prej tij në pikat e kalimit kufitar siç rezulton nga sistemi TIMS, kryesisht të dhëna për pronarët e mjeteve dhe lidhjen e tij me to, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se³⁶ *lidhur me automjetin me targa SH **, tip “Toyota” me hyrje - dalje më 11.8.2007 - 14.8.2007 në pikën kufitare Qafë -Thanë, sqaron se me këtë automjet në pronësi të shtetasës, znj. L.K., kanë kaluar në këtë pikë kufitare me familje për vizitë turistike, ajo me bashkëshortin e saj P.K., dhe subjekti së bashku me familjen. Mjeti është drejtuar nga çifti K., me të cilët kishin lidhje miqësore dhe familjare kohë më parë.*

25.4.8. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, duket se subjekti ka patur dijeni të plotë për blerjen e këtij automjeti, kjo pasi: (i) rezultojnë të dhëna që ai është përdorur gjatë një udhëtimit të kryer prej tij në vitin 2007, pra, ishte mjet i njohur për të; si edhe (ii) ky automjet është blerë në Shkodër me shitës miqtë/familjarët e subjektit (sipas vetëdeklarimit) dhe nuk mund të ketë qenë pjesë e mjeteve të autoservisit, në të cilin subjekti pretendon se ka punuar djali i tij.

25.4.9 Sa më sipër, duket se ka mospërputhje mes deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 2, për shkaqet e mosdeklarimit të kësaj pasurie ndër vite. Duket se subjekti ka patur dijeni për blerjen e këtij mjeti që në vitin 2008.

25.5 Analiza e burimit të të ardhurave të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie

³⁴ Pyetësin nr.2, pyetja nr. 8/ përgjigjet e depozituara nga subjekti.

³⁵ Kontrata noteriale e shtëblerjes, datë 2.2.2008 – pjesë e dosjes së dërguar nga DPSHTRR për këtë automjet.

³⁶ Përgjigjia e pyetjes nr. 1, të Pyetësin nr. 3.

Sikurse u tha më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie: (1) të ardhurat nga shitja për pjesë këmbimi të autoveturës tip “Toyota” me targë TR ***, në vlerën 2,000 euro dhe (ii) hua të afërmve në vlerën 2,600 euro.

a. Të ardhurat nga shitja për pjesë këmbimi të automjetit Toyota me targë TR ***

1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me mjetin “Toyota” me targë TR ***, konstatohet se ky automjet është blerë³⁷ nga personi i lidhur në shkurt të vitit 2008 (datë 26.2.2008) për vlerën prej 250,000 lekë dhe është nxjerrë jashtë përdorimit në datën 29.6.2012.

2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në vitin 2008 dhe as pakësimin e saj (nxjerrjen jashtë përdorimit) dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara në vitin 2012 dhe as ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për shumën e pretenduar si të përfituar në vitin 2012 nga nxjerrja jashtë përdorimi i këtij mjete.

3. Si rrjedhim, në analizën financiare nuk do të merren në konsideratë këto të ardhura si burim krijimi për blerjen e pasurisë së llojit “autoveturë”, të markës “Renault”.

b. Hua të afërmve në shumën 2,600 euro

1. Sikurse u konstatua më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” subjekti/personi i lidhur ka deklaruar si burimin për blerjen e pasurisë “Renault”, shumën prej 2,600 euro të pretenduar si të marrë hua nga i afërmi i tij.

2. Por, subjekti nuk ka deklaruar këtë hua në vitin 2012 dhe për më tepër, referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit 84/2016, personi i lidhur nuk ka konfirmuar këtë marrëdhënie dhe subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas së pretenduar.

3. Si rrjedhim, në analizën financiare nuk do të merren në konsideratë këto të ardhura si burim krijimi për blerjen e pasurisë së llojit “autoveturë”, të markës “Renault”.

25.5.1. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimet e të ardhurave të deklaruara për krijimin/blerjen nga djali i tij, të autoveturës të markës “Renault”, tip “Megane Scenic”, në shumën 4600 euro. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2012, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen e çmimit të blerjes së automjetit “Renault”, shtesën në likuiditete bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për periudhën 1.1.2012 - 31.12.201

25.6. Pas kalimit të barrës së provës për të gjitha konstatimet e mësipërme, subjekti dërgoi prapësimet e shoqëruara me shpjegimet përkatëse dhe prova të reja. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit çmon se, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se ai nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të kundërtën e rezultateve të hetimit.

25.7. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij për krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe konstatuara për periudhën 1.1.2012 - 31.12.2012, paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

³⁷ Kontrata e redaktuar nga noteri publik A.K., noter në dhomën e noterisë Shkodër.

Analiza financiare periudha 1.1.2012 - 31.12.2012	
Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimi subjekti i rivlerësimit; dokumentuar	1,840,016
Të ardhurat neto nga pagat, djali B.D.,	0
Të ardhura nga pensioni i nënës; dokumentuar	78,174
Të ardhura nga shitja “Toyota” (deklarative)	0
Hua nga të afërmit 2,600 euro (pa deklaruar DPV/2012, pa vërtetuar burimi)	0
Total të ardhura/të hyra financiare	1,918,190
Kredi ne “Raiffeisen Bank”	448,274
Kredi djali në “Credins Bank”	418,018
Shpenzime për shkollim, trajnime, përvoja profesionale	95,000
Shpenzime transporti SR; deklaruar	120,000
Shpenzime për udhëtime, pushime	293,139
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së	837,288
Total shpenzime	2,211,719
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-7,268
Mjete monetare të disponueshme (1)	-300,797
Blerje autoveturë “Renault”, në vlerë 4.600 euro.	642,114
Investim në banesën 3+1 kate në ***; vetëdeklaruar	250,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	892,114
Balanca e fondeve (1-2)	- 1,192,911

25.8. Sa më sipër Komisioni arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij (personat e lidhur) nuk kanë patur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për shlyerjen e çmimit të blerjes së automjetit “Renault”, shtesën në likuiditete bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme/investimeve për periudhën 1.1.2012 - 31.12.2012.

26. Pasuria e llojit “autoveturë”³⁸, marka “Mercedez Benz”, me targë AA * (AA ***), blerë në datë 6.9.2015, në vlerën prej 7,000 euro. Zotëron 100% të kësaj pasurie.**

26.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e autoveturës së markës “Mercedez Benz” me targa AA ***, me vlerë 5,000 euro dhe; (ii) 2,000 euro nga të ardhurat familjare.

26.1.1. Në rubrikën e veçantë të deklaratës “Vetting” ka deklaruar se automjeti i markës “Mercedez Benz” me targë AA *** i vitit 2003 është blerë në datën 13.8.2015 me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol.

26.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: rezulton mospërputhje lidhur me vlerën e shitjes së automjetit me targa AA ***, pasi në deklaratën e interesave private periodike 2015 dhe deklaratën e pasurisë “Vetting” është deklaruar vlera 5,000 euro, ndërkohë sipas kontratës së shitblerjes datë 31.7.2015 vlera e shitjes është 4,000 euro.

26.3. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV/2015 konstahet se personi i lidhur ka deklaruar pasurinë e llojit “autoveturë” të markës “Mercedez Benz”, me targë AA ***, blerë në datën 6.9.2015, me vlerë 7,000 euro. Si burim krijimi ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e autoveturës së markës “Mercedez Benz” me targa AA ***, në vlerën 5,000 euro; dhe (ii) shumën prej 2,000 euro nga të ardhurat familjare.

26.4. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

³⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.8.2015.

DPSHTRR-ja³⁹ konfirmon se personi i lidhur, B.D., ka në pronësi mjete me targë AA ***. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti konstatohet se në datë 18.8.2015, personi i lidhur ka blerë⁴⁰ pasurinë e llojit “autoveturë”, të markës “Daimler Chrysler”, tipi “211, E270, CDI”, me targë AA ***, vit prodhimi 2003, për vlerën prej 7,000 euro. Referuar dosjes së këtij mjeti duket se për shkak të humbjes së targës së parë AA ***, pas ndërrimit të saj, ka marrë targën AA ***.

26.5. Analiza e burimit të të ardhurave të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie

26.5.1. Komisioni mori në analizë burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur për krijimin e pasurisë objekt hetimi, automjetit “Mercedez Benz”, me targë AA ***, si vijon:

a. Të ardhurat nga shitja e automjetit “Mercedez Benz” me targa AA *, deklaruar në vlerën 5,000 euro**

26.5.2. Referuar informacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja, rezulton se në datën 24.12.2013 subjekti i rivlerësimit ka blerë⁴¹ automjetin e markës “Mercedez Benz”, tipi “C, 270, CDI”, me targë AA ***, për vlerën prej 5,000 euro. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV/2013. Në datën 31.7.2015, subjekti i rivlerësimit e ka shitur automjetin e sipërpërmendur për vlerën 4,000 euro.

26.5.3. Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjetit në vitin 2015, pasi ka mospërputhje në vlerën e vetëdeklaruar në DPV/2015 dhe deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” (deklaruar 5,000 euro) dhe vlerës së përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie (4,000 euro).

26.5.4. Gjithashtu, referuar DPV/2015, subjekti ka deklaruar hua në shumën prej 3,000 euro me afat të pacaktuar, marrë nga një mik i familjes në muajin gusht 2015 për pushime me bashkëshorten në Turqi.

26.5.5. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë marrëdhënie huaje, duke kërkuar dhe burimin e të ardhurave të huadhënësit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se⁴² *huan në vlerën 3,000 euro e ka marrë cash te miku i familjes Z. R.T., (burri i motrës), i cili i dispononte cash si të ardhura të sjella nga djali i tij nga Anglia për të investuar në shtëpinë e tij. Djali (nipi i tij) është i martuar në Angli dhe punon në një punishte të madhe mermeri si specialist.*

26.5.6. Referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. R.T., apo djali i tij bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast burimin e krijimit të shumës prej 3,000 euro, të pretenduar si të marrë hua nga subjekti i rivlerësimit.

26.5.7. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. R.T., apo djalit të tij, të cilat janë deklaruar si burim krijimi i kësaj huaje.

26.5.8. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1.1.2015 - 13.8.2015 për verifikimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie (blerjes së automjetit të markës “Mercedez Benz”) duket se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij (personat e lidhur) nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij automjeti në datën 13.8.2015, shtesën në likuiditeteve bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme.

³⁹ Shkresat nr. *** prot., datë 6.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 12.12.2019.

⁴⁰ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.8.2015..

⁴¹ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2013.

⁴² Përgjigjia e pyetjes nr. 10, të Pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni.

26.9. Pas kalimit të barrës së provës për të gjitha konstatimet e mësipërme, subjekti dërgoi prapësimet e shoqëruara me shpjegimet përkatëse dhe prova të reja. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit çmon se, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se ai nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruarra dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij për verifikimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie në datën 13.8.2015, duke përfshirë të ardhurat dhe hyrjet financiare të dokumentuara, si dhe pagesat/shpenzimet e kryera për periudhën 1.1.2015 - 13.8.2015, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Analiza financiare periudha 1.1.2015 - 13.8.2015	
Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimi subjekti i rivlerësimit sipas "Raiffeisen Bank"	924,818
Të ardhurat neto nga pagat djali B./subjekti i rivlerësimit sipas "Tirana Bank"	326,240
Te ardhura nga pensioni i nënës deri 1.1 – 31.7.2015	48,881
Te ardhura nga shitja e autoveturës "Daimler Chrysler C270CDI", me targë AA*** në datën 31.7.2015	549,120
Hua nga shtetasi R.T.;deklaruar për pushime	0
Total të ardhura /të hyra financiare	1,849,059
Hua e shlyer nga djali 1600 euro, deklaruar në DPV/2015	0
Shpenzime psr pushime në Turqi deklaruar shuma 3,000 euro dhe Selanik 100 euro; deklaruar	425,568
Shpenzime djali me CD në "Tirana Bank" për periudhën (kartë debiti)	60,132
Shpenzime transporti subjekti i rivlerësimit; deklaruar	70,000
Shpenzime për blerje të parcelës ndertimore datë 15.7.2015	323,440
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për 7 muaj	654,138
Total shpenzime	1,533,278
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-127,272
Mjete monetare të disponueshme (1)	188,509
Blerje autoveturë "Daimler Chrysler E270CDI" vit 2003 blerë nga djali në datën 13.8.2015, në shumën 7,000 euro	960,960
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	960,960
Balanca e fondeve (1-2)	- 772,451

27.1. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij (personat e lidhur) nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme, nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij automjeti në datë 13.8.2015, shtesën në likuiditetet bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme.

❖ Pasuritë e deklaruarra veçmas nga vajza e subjektit, B.D.

28. Pasuria e llojit "autoveturë" e markës "Opel", tipi "Corsa"⁴³, e vitit 2000, me targë AA*, e blerë në vitin 2013, për shumën prej 1,500 euro.**

28.1. Personi i lidhur, B.D., ka deklaruar se këtë pasuri e ka dhuratë nga bashkëjetuesi, z. A.Z.

⁴³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): certifikatë pronësie e automjetit "Opel Corsa" me targë AA***.

28.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: përputhet deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i dorëzuar me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-së. (nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me mundësinë financiare të shtetasit A.Z.).

28.3 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti i rivlerësimi në ILDKPKI, konstatohet se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në vitin 2015. Sipas DPV/2015, personi i lidhur, B.D., ka deklaruar se ka në pronësi pasurinë e llojit “autoveturë” të markës “Opel”, tipi “Corsa”, e vitit 2000, me targë AA ***, të cilën e ka blerë në vitin 2013, me vlerë 1,500 euro dhe se 100% e vlerës i është dhuruar nga bashkëjetuesi.

28.4. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

28.4.1. DPSHTRR-ja⁴⁴ konfirmon se personi i lidhur, B.D., ka në pronësi automjetin me targë AA ***. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se në datë 14.12.2013, personi i lidhur, B.D., e ka blerë⁴⁵ këtë automjet për vlerën prej 169,200 lekë.

28.4.2. Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV/2013. Sipas pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. A. Z., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast burimin e krijimit të shumës prej 1,500 euro deklaruar si e dhuruar në favor të personit tjetër të lidhur për blerjen e pasurisë së mësipërme.

28.4.3. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. A.Z., të cilat janë deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie.

28.4.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁴⁶, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *deklarimin e automjetit tip “Opel Corsa” me targë AA *** nuk e ka bërë për arsye se nuk ka patur dijeni që vajza e tij, B.D., e dispononte këtë mjet në emër të saj dhe e ka neglizhuar si aset, duke qenë se kjo shumë nuk është investuar nga të ardhurat e familjes. Vlerën për blerjen e këtij automjeti, në dijeninë e tij i është dhënë cash nga bashkëjetuesi, z. A.Z., në momentin e blerjes së këtij automjeti. Burimi i të ardhurave të bashkëjetuesit janë nga paga dhe të ardhurat e tij familjare.*

28.4.5. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti depozitoi deklaratë noteriale⁴⁷ të shtetasit A.Z., të datës 28.10.2020, sipas të cilës ai deklaroi se i ka blerë bashkëjetueses së tij, znj. B. D., automjetin objekt vlerësimi. Gjithashtu, për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer si burimi krijimi për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka depozituar si provë të re vërtetimin e datës 3.11.2020, sipas të cilit personi tjetër i lidhur për periudhën nga data 10.7.2010 deri në datën 30.4.2013 ka qenë i punësuar si shofer në Prokurorinë e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

28.4.6. Si përfundim, nga analiza e shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti lidhur me këtë pasuri, si edhe duke konsideruar faktin se ky automjet është përfituar nga vajza e subjektit si dhuratë nga personi tjetër i lidhur, Komisioni vlerëson se pasaktësia në mosdeklarimin e saj në DPV-në e vitit 2013 është pa pasojë dhe se nuk ka dyshime për krijimin e kësaj pasurie.

❖ Pasuritë e deklaruara veçmas nga vajza e subjektit, B.D.

⁴⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 6.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 12.12.2019.

⁴⁵ Fatura tatimore nr. serial ***, datë 14.12.2013.

⁴⁶ Pyetësori nr.2, pyetja nr. 9/ përgjigjet e depozituara nga subjekti.

⁴⁷ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2020.

29. Pasuria e llojit “autoveturë” e markës “Lancia”, tipi “Y”⁴⁸, e vitit 2002, me targë AA *, e blerë në datë 10.2.2014, për shumën prej 1,000 euro.**

29.1. Si burim krijimi të kësaj pasuri ka deklaruar të ardhurat familjare, duke përfshirë dhe të ardhurat e bashkëshortit.

29.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: subjekti nuk ka bërë ndryshimin e pronësisë së automjetit.

29.3. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti i rivlerësimi në ILDKPKI, konstatohet se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në vitin 2015. Referuar DPV/2015, personi i lidhur, B.D., ka deklaruar se ka në pronësi pasurinë e llojit “autoveturë” të markës “Lancia”, tipi “Y”, e vitit 2002, me targë AA ***, të cilën e ka blerë në datë 10.2.2014, me vlerë 1,000 euro, me burim krijimi të ardhurat familjare, duke përfshirë dhe të ardhurat e bashkëshortit.

29.4. Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

29.4.1. DPSHTRR-ja⁴⁹ nuk konfirmon pronësinë e këtij automjeti në emër të personit të lidhur, B.D., por, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së konstatohet se në datën 10.2.2014, personi i lidhur, B.D., ka blerë⁵⁰ këtë pasuri nga shtetasja V.Q., vlerën prej 1,000 euro. Gjithashtu, DPSHTRR-ja⁵¹ informon se mjeti me targë AA *** është në pronësi të shtetasës V.Q.

29.4.2. Në vijim të hetimeve të kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, pas kërkimit të dosjes së plotë të këtij mjeti⁵² dhe nga verifikimi i dosjes së DPSHTRR-së⁵³, rezulton se ai figuron i regjistruar në emër të shtetasës V.Q.

29.5. Sa më sipër, duket se personi i lidhur nuk ka depozituar kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie në DPSHTRR-së për ndryshimin e pronësisë së automjetit, si dhe nxjerrjen e certifikatës së pronësisë në emrin e saj.

29.5.1. Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimi/personi i lidhur nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV/2014. Personi i lidhur, në DPV/2015 dhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se si burim krijimi i kësaj pasuri janë të ardhurat familjare dhe të bashkëshortit të saj, por nuk ka saktësuar kontributin përkatës dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për burimin e të ardhurave të pretenduara nga bashkëshorti i saj, deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie.

29.5.2. Gjithashtu, nisur nga fakti i mosdeklarimit të kësaj pasurie dhe burimit përkatës të krijimit nga vajza e subjektit në DPV/2014, si dhe mospërcaktimit/mosargumentimit të kontributeve përkatëse të deklaruara në deklaratën “Vetting” (duke mos dokumentuar burimin e krijimit), u krye analiza financiare për periudhën 1.1.2014 - 10.2.2014, nga ku duket se, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij (personat e lidhur) nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij automjeti në datën 10.2.2014, shtesën në likuiditetet bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për periudhën 1.1.2014 - 10.2.2014.

29.6. Pas kalimit të barrës së provës për të gjitha konstatimet e mësipërme, subjekti dërgoi prapësimet e shoqëruara me shpjegimet përkatëse, duke parashtruar se *mosdeklarimi i i këtij*

⁴⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratën (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): kontratë shitblerje automjeti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2014.

⁴⁹ Shkresat nr. *** prot., datë 6.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 12.12.2019.

⁵⁰ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2014.

⁵¹ Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2017 – ndodhur Aneks *** në dosjen e ILDKPKI.

⁵² Shkresa nr. *** prot., datë 4.8.2020.

⁵³ Shkresa nr. *** prot., datë 13.8.2020.

automjeti në DPV/2014, për të cilin në referencë të akti të blerjes datë 10.02.2014 duhej të ishte deklaruar në këtë periudhë, mendon se mosdeklarimi në kohën e duhur ka qenë neglizhenca apo rëndësia e kushtuar, duke menduar edhe cilësuar si vlerë më e vogël se 300,000 lekë, vlerë e cila konsiderohej si jo e detyrueshme në deklarim edhe pse kjo pasuri ishte e regjistrueshme në institucionet shtetërore. Gjithashtu, në lidhje me regjistrimin e kësaj pasurie pranë DPTSHRR-së, mendon se arsyeja për mosregjistrimin e këtij automjeti për t'i ndryshuar pronësinë në emrin e saj ka qenë edhe gjendja teknike e këtij automjeti, gjatë periudhës së përdorimit, pasi ishte një automjet që do mbahej në përdorim për një kohë të shkurtër dhe i cili nuk ia vlente të koloadohej.

29.7. Komisioni vlerëson se nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore të vitit përkatës dhe se, gjithashtu, subjekti sërish nuk ka saktësuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke mos ngritur asnjë pretendim për analizën financiare të kryer nga Komisioni, të dërguar me rezultatet e hetimit. Komisioni çmon se, megjithëse ky automjet nuk ka vlerë të konsiderueshme, subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur për të saktësuar burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, një pjesë e të cilave pretendohen si burim krijimi i kësaj pasurie. Në rrethana të tilla, Komisioni vlerëson se subjekti/peroni i lidhur ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie.

29.8. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruarra dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2014 - 10.2.2014 për të analizuar mundësinë financiare të familjes Dragjoshi për blerjen e kësaj autoveture në datën 10.2.2014, pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 5

Analiza financiare periudha 1.1.2014-10.2.2014	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat + shpërblime sub.rivl., sipas "RFZ Bank" - për periudhën	211,638
Të ardhurat neto nga pagat e vajzës B., referuar ISSH-së	44,400
Të ardhura nga pensioni i nënës	13,827
Total të ardhura/të hyra financiare	269,865
Shlyerje kredie "Raiffeisen Bank"	22,398
Shpenzime transporti SR; deklaruar	13,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	148,272
Total shpenzime	183,670
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-63,239
Mjete monetare të disponueshme (1)	22,956
Blerje autoveture "Lancia Y" nga vajza në shumën 1000 euro	140,140
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	140,140
Balanca e fondeve (1-2)	- 117,184

29.9. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij automjeti në datën 10.2.2014, shtesën në likuiditete bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për periudhën 1.1.2014-10.2.2014.

30. GJETJE TË TJERA

Blerja e automjetit të markës “Toyota” në vitin 2008

30.1. Sikurse u shpreh më sipër, në datën 26.2.2008, personi i lidhur, B.D., ka blerë automjetin e markës “Toyota” për shumën prej 250,000 lekë, por kjo pasuri nuk është deklaruar në DPV/2008.

30.1.1. Për të vënë në dukje ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij (personave të lidhur), të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti në datën 26.2.2008 (duke marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara, ndryshimet në pasuri, likuiditete, si dhe shpenzimet e deklaruara dhe konstatuara), Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2008 - 26.2.2008, të pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 6

Analiza financiare periudha 1.1.2008 - 26.2.2008	
Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimi subjekti i rivlerësimit sipas “Raiffeisen Bank” për periudhën	212,458
Të ardhura nga pensioni i nënës (mesatarisht për 2 muaj)	10,432
Total të ardhura /të hyra financiare	222,890
Shlyerje kredie “Raiffeisen Bank”	48,636
Shpenzime transporti SR; deklaruar	20,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	128,011
Total shpenzime	196,647
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj.monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-8,181
Mjete monetare të disponueshme (1)	18,062
Blerje autoveture “Toyota” nga djali në datën 26.2.2008	250,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	250,000
Balanca e fondeve (1-2)	- 231,938

30.1.2. Nga analiza e kryer konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij (personat e lidhur) nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij automjeti në datën 26.2.2008, shtesën në likuiditete bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për periudhën 1.1.2008 – 26.2.2008.

30.1.3. Pas kalimit të barrës së provës subjekti dërgoi prapësimet e shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit çmon se, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se ai nuk arriti të provonte të kundërtën e këtij konstatimi.

Blerja e automjetit të markës “BMW X5”, në vitin 2011

30.2. DPSHTRR-ja⁵⁴ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka patur në pronësi automjetin me targë AA *** (targa e mëparshme AA ***), dhe ka vënë në dispozicion dosjen e plotë të këtij mjeti.

30.2.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar për këtë automjet konstatohet se: (i) referuar DAVR*** (deklarata doganore), datë 4.10.2011, ky mjet është deklaruar nga importuesi me vlerë 5,000 euro; (ii) dogana për efekt të pagesës së detyrimeve doganore e ka vlerësuar në vlerën 1,134,755 lekë; (iii) është paguar detyrimi doganor në shumën prej 226,950

⁵⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 6.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 12.12.2019.

lekë; (iv) në datë 8.10.2011 (4 ditë pas zhdoganimit) subjekti i rivlerësimit e blen këtë automjet për vlerën 5,000 euro.

30.2.2. Referuar kontratës së shitblerjes së këtij automjeti⁵⁵, shitësi ka deklaruar se ia shet këtë automjet, z. B.D., për shumën prej 5,000 euro, të cilën do ta merrte me regjistrimin e këtij mjete. Duket se ky automjet është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 17.10.2011.

30.2.3. Nga verifikimi i DPV/2011, konstatohet se blerja e këtij mjete nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si shtesë pasurie për vitin 2011. Por, vërehet se në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredi me afat njëvjeçar në “Raiffeisen Bank” në shumën 500,000 lekë – për blerje automjeti.

30.2.4. Nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga “Raiffeisen Bank”⁵⁶ konfirmohet se në datën 10.10.2011 në llogarinë e subjekti të rivlerësimit është disbursuar kredia në shumën 500,000 lekë. Gjithashtu, rezulton se në datën 26.9.2011, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”, shumën 400,000 lekë.

30.2.5. Referuar të dhënave të mësipërme, vlerës së këtij mjete para zhdoganimit, shpenzimet e kryera për zhdoganimin e tij, si edhe nisur nga fakti se para pagesës së kryer për blerjen e këtij mjete subjekti i rivlerësimit ka kryer dy tërheqje në vlera të konsiderueshme nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” (në datën 26.9.2011 ka tërhequr shumën 400,000 lekë dhe në datën 10.10.2011 ka tërhequr shumën prej 500,000 lekë), Komisioni ngre dyshime të arsyeshme lidhur me vlerën reale të blerjes së tij.

30.2.6. I pyetur lidhur me këto fakte si edhe shpjegimin e marrëdhënies me shitësin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *lidhur me çmimin e shitjes ka për të thënë se automjetin e ka kaluar për kontroll në një servis dhe i është thënë së pjesët e saj kushtojnë shumë, ku një pjesë e tyre janë amortizuar, pasi kanë kryer orët e punës dhe kërkojnë shërbim. Kjo ishte edhe arsyeja e uljes së çmimit, edhe pse fillimisht ai ishte i lartë nga shitësi. Me shtetasin A.H., (shitësin e këtij automjeti) nuk ka asnjë lloj lidhjeje, përveçse e njeh si tregtar automjetesh në qytetin të Shkodrës. Shuma e kredisë së bashku me shumën e tërhequr nga “Raiffeisen Bank” i ka përdorur për likuidimin e vlerës së kërkuar të automjetit tip “BMW X5”. Shitësit ia ka dhënë të gjithë vlerën e kërkuar jashtë zyrës noteriale, brenda një kohe të shkurtër, ashtu siç thuhet në kontratën noteriale, likuidimi i vlerës do bëhej në momentin e regjistrimit ose targimit të automjetit si një garanci për të shmangur ilegalitetin e dokumenteve të huaja (dhe jo në momentin e dorëzimit).*

30.2.7. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjekti të konfirmojë nëse ka pasur si prokuror dosje procedimi penal të mosfilluar, pushuar, pezulluar apo të dërguar për gjykim, ku si kallëzues/të kallëzuar/persona ndaj të cilit zhvillohen hetime/të dëmtuar/të pandehur të kenë qenë shtetasit P.L., shitësi i këtij automjeti dhe A.H, përfaqësues me prokurë i shitësit.

30.2.8. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti në mënyrë deklarative parashtrroi para Komisionit se *me shtetasit e sipërcituar nuk ka pasur asnjë dosje procedimi penal të mosfilluar, pushuar, pezulluar apo të dërguar për gjykim, ku si kallëzues/të kallëzuar/persona ndaj të cilit zhvillohen hetime/të dëmtuar/të pandehur të kenë qenë këta shtetas, porse siç ka deklaruar edhe më parë shtetasin A.H., ka thjesht njohuri se është shitës automjetesh në qytetin e Shkodrës, ndërsa shtetasin P.L., nuk e ka njohur asnjëherë dhe nuk e njeh as sot.* Por, vërehet se subjekti në prapësimet e tij nuk paraqiti shpjegime lidhur me dyshimet e ngritura nga Komisioni lidhur me vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie.

30.2.9. Në këtë kuptim, nisur nga vetëdeklarimet e bëra nga subjekti si edhe nga analiza e informacionit/dokumentacionit të administruar lidhur më këtë pasuri, Komisioni i qëndron

⁵⁵ Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2011.

⁵⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2019.

konstatimit të bërë me rezultatet e hetimit, duke ngritur dyshime të arsyeshme se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së këtij automjeti nuk përfaqëson vlerën reale të blerjes së tij nga subjekti i rivlerësimit.

30.3. Gjithashtu, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2011, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (shtesën në likuiditete bankare), si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme të deklaruara dhe të konstatuara për vitin 2011.

30.4. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve subjekti nuk ka ngritur asnjë pretendim për analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2011, të dërguar me rezultatet e hetimit.

30.5. Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2011-31.12.2011, të paraqitur në tabelë si më poshtë:

Tabela nr. 7

Analiza financiare periudha 1.1.2011-31.12.2011	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimi subjekti i rivlerësimit; dokumentuar	1,900,635
Të ardhurat neto nga pagat; djali B.	0
Të ardhura nga pensioni i nënës; dokumentuar	75,474
Kredi e marrë në "Raiffeisen Bank"	500,000
Total të ardhura /të hyra financiare	2,476,109
Kredi në "Raiffeisen Bank"	90,023
Kredi djali në "Credins Bank"	255,802
Shpenzime për shkollim, trajnime, përvoja profesionale	347,325
Shpenzime për riparim automjeti "BMW X5" deklaruar pyetësor nr. 2	400,000
Shpenzime transporti SR; deklaruar	120,000
Shpenzime të tjera, komisione	20,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së	819,720
Total shpenzime	2,052,870
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-83,470
Mjete monetare të disponueshme (1)	339,769
Blerje autoveturë "BMW X5" në datën 8.10.2011, çmim blerjeje 5,000 euro	694,650
Investim në banesën 3+1 kate në ***	250,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	944,650
Balanca e fondeve (1-2)	- 604,881

30.6. Nga analiza e kryer konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij (personat e lidhur) nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (shtesën në likuiditete bankare), si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme të deklaruara për vitin 2011.

30.7. Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

30.7.1. Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve ndër vite; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur në vazhdimësi kanë kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurive, duke mos i deklaruar në kohë ato apo duke mos deklaruar saktë të dhënat e pasurisë dhe burimin e krijimit të tyre; (iii) ngrihen

dyshime të arsyeshme lidhur me vlerën e blerjes së automjetit të markës “BMW”, tipi “X5”, pasuri e blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011.

30.7.2. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara; dhe (2) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

B. KONTROLI I FIGURËS

31. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ai ka/pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

31.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁵⁷ mbi kontrollin e figurës, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaramtën për kontrollin e figurës; dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

31.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi⁵⁸.

31.3. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit subjektit të rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjensitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

32. Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

33. Subjekti i rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, (i) në periudhën 3.9.1993 – 1.4.1995 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Kukës; (ii) në periudhën 1.4.1995 – 16.16.1998 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Has; (iii) në periudhën 16.6.1998 – 15.10.2002 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Kukës dhe; (iv) për periudhën tetor 2002 – aktualisht, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

34. Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

⁵⁷ Raporti me nr. *** prot, datë 31.10.2017.

⁵⁸ Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e K.D.ZH me nr. ***, datë 12.12.2019.

34.1. Ky raport⁵⁹ është përgatitur nga komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016.

34.2. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

34.3. Të dhënat nga burimet arkivore: nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit Brahim Dragjoshi: (a) nuk rezultojnë të ketë pasur masa disiplinore; (b) nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale); dhe (c) nuk ka pasur ndaj tij materiale hetimore të regjistruara/çështje apo kallëzim penal të filluar, procedime penale të pushuara apo pezulluara; dhe (d) nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2018, rezultojnë se nuk ka asnjë ankesë. Gjitashtu, rezultojnë se për periudhën 2014 – 2016, bazuar në vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë”.

34.4. Nga analiza e përgjithshme e këtij raporti, duket se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe në arsyetimin ligjor. Ai ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

34.5. Por, nga verifikimi i detajuar i raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit si edhe pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor mbi të cilën është hartuar ky raport, duket se kanë dalë në pah disa gjetje, për të cilat, Komisioni i kërkoi shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit.

34.6. Për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 3 denoncime të depozituara nga publiku në Komision, për të cilat iu kërkua shpjegime.

34.7. Subjekti dërgoi prapësimet e shoqëruara me shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e konstatuara nga raporti i KLP-së dhe për denoncimet e depozituara nga publiku në Komision. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi gjetjet në raportin e KLP-së, si edhe problematikat e ngritura në denoncimet e publikut, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana apo problematika thelbësore, të cilat mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional.

35. Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

35.1. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjyqësor vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

35.2. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

⁵⁹ Raporti nr. *** prot., datë 16.9.2019.

35.3. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

1. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. subjekti arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4 si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Brahim Dragjoshi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 16.11.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Anëtar

Pamela Qirko
Relatore

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini